AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**Menaxhim Biznesi**

**Kolegji Universitar "Qiriazi"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Etleva Leskaj**

**PhD. Ani Mbrica**

**Qershor / 2024**

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Bachelor në "Menaxhim Biznesi"

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar "Qiriazi" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhim Biznesit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Menaxhim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër MAS Nr. 204, datë 03.07.2020 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i 6 (gjashtë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2022 - 2023: 19 PAE / 3 PAK<br>2021 - 2022: 20 PAE / 3 PAK<br>2020 - 2021: 17 PAE / 8 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2020 – 2021; 15 studentë<br>2021 – 2022; 9 studentë<br>2022 – 2023; 12 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | Ky program ka ardhur nga riorganizimi i programit Bsc. Menaxhim Biznesi (i cili ka ardhur is riorganizim i programit 4 vjecar Menaxhim Biznesi, akredituar me VBA Nr. 103, datë 02.11.2019 vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2019-2020 dhe që aktualisht ndjekin studimet në këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre. |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim Biznesi Biznesi" ka filluar të zhvillohet në vitin 2006 dhe në vazhdim. Ai është hapur me VKM Nr. 274, datë 10.05.2006 dhe eshte riorganizuar me UMAS nr. 204, datë 03.07.2020.

Programi zhvillohet nga Departamenti i Menaxhim Biznesit, në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Kolegjit Universitar "Kuq". Objektivi kryesor i programit Bachelor në "Menaxhim Biznesi Biznesi" është t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre profesional si specialistë të Menaxhim Biznesit në të gjitha fushat e tij. Tërësia e njohurive, që marrin studentët, ndikon në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkencave të ekonomisë, menaxhim biznesit, financës, marketingut dhe kontabilitetit, me objektiv formimin e specialistëve për të punuar në fushen e Menaxhim Biznesi dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.

Programi synon të përgatisë administratorë biznesi të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme dhe të sektorit shtetëror. Gjithashtu, ky program synon të përgatisë specialistë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushën e administrimit të biznesit. Në përfundim të programit studenti aftësohet për t'u punësuar në njësitë e ndryshme ekonomike dhe sektorët që lidhen me funksionet bazë të administrimit të biznesit si marketing, menaxhim biznesi prodhimi, menaxhim i burimeve njerëzore, në sektorin privat dhe administratën publike.

Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat, që marrin studentët nëpërmjet harmonizimit të njohurive me bazë teorike, të fushës dhe ato ndihmëse e duke vijuar me thellime në fushat menaxhimit, marketingut, financës etj., krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën përformon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.As.Dr. Etleva Leskaj dhe Dr. Ani Mbrica. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Z. Rajna Lila, Koordinatorja teknike e kësaj procedure.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vleresimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Kolegjin Universitar KUQ që u zhvillua në muajin tetor 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimt të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të studentëve të diplomuar. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra me programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” duke dhënë disa sugjerime/rekomandime.

**Më datë 14.05.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 76/7 Prot., Datë 14.05.204, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 66 Prot, Datë 20.05.2024.**

Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi".

**GVJ duke vlerësuar komentet e Institucionit, përcjell qëndrimin rreth tyre si më poshtë:**

***Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Bachelor Menaxhim Biznesi, KUQ***

**GVJ duke vlerësuar komentet e Institucionit, përcjell qëndrimin rreth tyre si më poshtë:**

**1. Standardi II.1 & II.4**

Në Draft RVJ shprehet se "GVJ gjykon që programi duhet të garantojë llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh, duke mos u fokusuar dhe profilizuar në drejtim të financës, siç vihet re dhe nga pesha që zënë lëndët me karakter financiar në kurrikulën e këtij programi studimi."

*Qëndrimi i GVJ*: GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit për të konsideruar gjykimin e GVJ për të rishikuar kurrikulën e programit të studimit për rritjen e peshës dhe numrin e lëndëve në fushën e menaxhimit.

**2. Standardi II.4 & II.5**

Në Draft RVJ shprehet se "Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi menaxhimin e organizatave të ndryshme publike dhe private, por nevojitet që programi i studimit të përfshijë më tepër shumëllojshmëri njohurish që lidhen me fushën e meanxhimit të biznesit dhe jo të fokusohet dhe profilizohet në drejtimin financiar. Për këtë nevojitet një analizë më e detajuar e tregut të punës që nxjerr ne pah nevojat aktuale të ttij apo aftësitë që kërkohen më tepër. Gjithashtu nevojitet përfshirja e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë."

"*GVJ sugjeron se IAL duhet të realizojë* takime me bordin e tregut të punës, Alumni për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës."

*Qëndrim i GVJ:* GVJ vlerëson punën e bërë nga Institucioni për ofrimin e praktikës dhe mundësive të ndryshme të punësimi për studentët e këtij programi studimi nëpërmjet partneriteteve qe ka vendosur me organizata dhe sipërmarrje te ndryshme, por këto aktivitete nuk nxjerrin në pah nevojat e tregut të punës, aftësistë që kërkohen të zotërojnë studentët kur dalin në tregun e punës. Gjithashtu, GVJ vlerëson punën e bërë nga Institucioni për mbledhjen e të dhënave nga organizata dhe biznese partnere në lidhje me rekomandime për përmirësime të kurrikulave aktuale, por në studimin e tregut të vendosur në dispozicion nga Institucioni nuk gjendet analizë e këtyre të dhënave në lidhje me programin e studimit. Për më tepër, nuk gjenden as rekomandime apo sugjerime nga Alumni, studentë të diplomuar nga ky program studimi të cilët sot janë pjesë e tregut të punës dhe operojnë me sukses në të. Studimi i tregut nuk përmban metodologjinë e ndjekur në realizimin e një studimi të tillë me partnerët. Nuk përmendet kampioni i marrë në analizë, pra numri i organizatave dhe sipërmarrjeve që kanë plotësuar një pyetësor të tillë. Për më tepër në studimin e tregut nuk gjejmë rezultate nga një analizë me partnerët mbi aftësitë qe sot kërkon tregu i punës të cilat duhet t'i zotërojnë studentët në mbarim të studimeve. Gjithashtu, nuk gjejmë informacione të organizatave dhe bizneseve që janë marrë në studim në lidhje me aftësitë që i mungojnë studentëve kur përballen me tregun e punës apo rekomandime në lidhje me aftësitë që nevojiten të fitohen nga studimi për pozicione të caktuara të punës në fushën e menaxhimit. Një analizë e tillë ndihmon Institucionin dhe sidomos njësinë përgjegjëse të këtij programi studimi për të evidentuar lëndët për të cilat kanë nevojë më tepër studentët që të aftësohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

### 3. Standardi III.5

Në Draft RVJ shprehet se "GVJ sugjeron që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përgatisë një udhëzues të posaçëm për procesin dhe përgatitjen e temës së diplomës."

*Qëndrim i GVJ:* GVJ vlerëson argumentet shtesë që ka dhënë Institucioni në lidhje me udhëzuesin e përgatitjes së temës së diplomës dhe vendos të pranojë komentin për rishikimin e sugjerimit të këtij standardi.

### 4. Standardi IV.3

Në Draft RVJ shprehet se: "GVJ konstaton se kushtet fizike të bibliotekës se KUQ, janë të përshtatshme për t'ju shërbyer studentëve dhe stafit akademik. GVJ sugjeron shtimin me tituj të fundit të fondit fizik dhe rregjistrim në biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi dhe studentët. GVJ sugjeron pasurimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet e viteve të fundit të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi si dhe rritjen e kapciteteve infrastrukturale te bibliotekës me poste fizike, Pc dhe biblioteka elektronike të aksesueshme në to.

*Qëndrim i GVJ:* GVJ vlereson përpjekjet e institucionit për pasurimin e bibliotekes, por pavarësisht kësaj, GVJ i qëndron të njëjtit vlerësim, duke iu referuar kapaciteteve fizike

infrastrukturale të bibliotekës në institucion si dhe fondit të librit, që u konstatua gjatë vizitës në instiutcion.

**5. Standardi IV.4 kriteri 5**

Në Draft RVJ shprehet se: "Pavarësisht potencialit që sistemi ka, GVJ sugjeron që institucioni të sensibilizojë studentët kryesisht, por edhe stafin akademik për përdorimin e sistemit dhe minimizimin e formave tradicionale të komunikimit me studentët, të notave, ankimimeve apo informacioneve të tjera, dhe përforcimin rutinor të përdorimit të sistemit prej tyre.

*Qëndrim i GVJ:* GVJ vlerëson pozitivisht incentivat e institucionit të përcjella në komente mbi draft-RVJ për invetsimet e bërë për sistemin informatik, por pikërisht se GVJ ka këtë vlerësim, inkurajon institucionin që të sensibilizojë studentët kryesisht, por edhe stafin akademik për përdorimin e sistemit dhe minimizimin e formave tradicionale të komunikimit me studentët, të notave, ankimimeve apo informacioneve të tjera, dhe përforcimin rutinor të përdorimit të sistemit prej tyre, tashme qe ky sistem eshte realitet ne institucion. Për sa më siper GVJ i qëndron vleresimit te meparshem te ketij standardi/kriteri.

**6. Vlerësimi i Fushës IV.**

Duke qënë se qendrimi i GVJ për standardet IV.3 dhe IV.4, nuk ndryshoi, dhe vleresimi tërësor i kësaj fushe, mbetet i pandryshuar.

**7. Standardi V.3**

Në Draft RVJ shprehet se "GVJ rekomandon që aktiviteti i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës duhet të jetë më i organizuar, më vizibël, më proaktiv, me frekuent, mbështetur në aktivitete të përshatura me nevojat e studentëve, sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve".

*Qëndrim i GVJ:* GVJ vlerëson argumentet shtesë dhe dokumnetacionin shtesë, që ka vendosur në dispozicion për raportin për aktivitetin vjetor të ZMJP &KK 22-23, dhe vendos të pranoje komentin e institucionit për rishikimin e vlerësimit të këtij standardi nga kryesisht në plotësisht.

**8. Standardi V.4**

Në Draft RVJ shprehet se: "GVJ sugjeron, që institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për rritjen e numrit të studenteve të regjistruar në programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi si dhe të cilësisë së tyre".

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

*Qëndrim i GVJ:* Komenti i institucionit, rreth problematikave të rënies se numrit te studenteve ne nivel makro jo vetem per KUQ, per arsye qe i perkasin ndryshimeve demografike, pranohet. Standardi V.4 ndryshon vleresimin nga kryesisht ne plotesisht.

**9. Vlerësim i Fushës VI**

*Qëndrim i GVJ*: GVJ vlerëson punën e bërë nga institucioni për sigurimin e brëndshëm të cilësisë. Për sugjerimet e lëna mbështet në dokumentacionin e dosjes së vetevlerësimit si dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion. Në komentet e përcjella, institucioni nuk përcjell komente te adresuara për kritere apo standard specifike të kësaj fushe dhe për vlerësimin e tyre. GVJ nuk gjen informacion relevant shtesë në këto komente, që nuk ka qënë më herët i konsideruar, prandaj për sa më sipër i qëndron të njëjtit vlerësim tërësor për këtë fushë.

**<u>Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Menaxhim Biznesi".</u>**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" i ofruar nga departamenti i Menaxhim Biznesi, në Fakultetin e Ekonomisë në Kolegjin Universitar "Qiriazi", është në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura tek Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional të Kolegjit Universitar "Qiriazi" 2021-2026, Pika 1.4 & 1.5. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit. Institucioni synon të përgatisë studentë, specialist të lartë dhe profesionistë me njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit për të kontribuar në zhvillimin e vendit. KUQ synon gjithashtu të zhvillojë kërkim shkencor bazë dhe aplikativ me impakt ekonomik dhe social në rajon. Ky program i paraprin sfidave të politikave të zhvillimit ekonomik në vendin tonë në |

| | |
|---|---|
| | mbështetje të interesave kombëtare si edhe të prioriteteve të zhvillimit, siç edhe përcaktohen tek shtylla II-Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër dhe shtylla III- Kohezioni social të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030.<br><br>Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e KUQ, të përcaktuara tek strategjia për zhvillimin e KUQ, tek e cila nënvizohet: "identifikimi i tij si një institucion lideri aftë të ofrojë një edukim ndërdisiplinor, një mjedis funksional dhe social aktiv ku me përgatitjen e specialistëve me integritet të hidhen edhe bazat e përgatitjes për jetën dhe projektimin e karrierës së synuar". Në kuadër të vizionit të tij KUQ synon të bëhet një institucion lider duke "vendosur standarde të larta në mësimdhënie, kërkim shkencor, profesionalizëm dhe integritet". Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit të Studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" gjithashtu tek misioni i tij "në përputhje me misionin e KUQ thekson se kërkon të përgatisë studentë me formim të shëndoshë profesional e social për t'u përshtatur me zhvillimet e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit". GVJ gjykon se KUQ nëpërmjet programeve të tij, veçanërisht Bachelor në "Menaxhim Biznesi", objekt i vlerësimit, përçon vlerat akademike dhe kulturore të vendit, në përputhje të plotë jo vetëm me karakteristikat e modelit të tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, por çka është më thelbësorja me burimet natyrore e njerëzore për një përdorim efektiv të tyre, me qëllim rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.<br><br>*Reference:Evidenca An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021*<br><br>*Reference: Evidenca An._1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"*<br><br>*Evidenca An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me | KUQ i udhëhequr nga misioni i përgatitjes së studentëve si specialist të lartë dhe profesionistë me njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit për të |

| | |
|---|---|
| qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | kontribuar në zhvillimin e vendit, ka hartuar dhe realizon programe, të cilat garantojnë përvetësimin e dijeve dhe njohurive shumëdimensionale. Konkretisht me anë të programit Bachelor në "Menaxhim Biznesi", KUQ kërkon të: "Të përgatisë specialistë të kualifikuar në fushën e menaxhimit duke iu përshtatur kërkesave të kohës duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit". GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" në ciklin e parë të studimeve, si pjesë e Departamenti i Menaxhim Biznesi hartohet dhe ofrohet në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimin dhe misionin e tij.<br><br>*Reference:Evidenca An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021*<br><br>*Reference: Evidenca An._1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"*<br><br>*Evidenca An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf;*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Menaxhim Biznesi. Rregullorja e departamentit si edhe rregullorja e programit "Menaxhim Biznesi" përcaktojnë qartë objektivat e programit, si një program që synon të përgatisë studentët të jentë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale të fushës së menaxhimit të biznesit si në sektorin privat edhe në atë publik. Gjithashtu synon të formojë specialistë të fushës së menaxhimit me aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale, të gatshëm për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit të shoqërive tregtare.<br><br>GVJ gjykon që ky program përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit Institucional, e cila i kushton vëmëndje të veçantë gjetjes së mënyrave novatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit, dhe përtej tyre kontribuar në realizimin e objektivave te zhvillmit ekonmomik dhe social të vendit. Statuti i Institucionit, Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike, në të cilat saktësohet Njësia bazë si një qendër bashkëkohore studimi, |

| | |
|---|---|
| | kërkimi dhe transferimi të njohurive, për t'u bërë pjesë integrale e një bote, ku studentët e diplomuar në Fakulteti i Ekonomisë, të gjejnë veten e tyre dhe të kontribojnë me dije e profesionalizëm në fushën e menaxhimit të biznesit, financave në kuadër të integrimit Evropian të vendit. GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimet themelore akademike të institucionit. Siç nënvizohet edhe tek Rregullorja e Fakultetit (neni 17 & 20), të gjitha programet e studimit janë bashkëkohore, plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane, si edhe të harmonizuara në fusha që plotësojnë njëra-tjetrën. Programet janë të organizuara dhe mundësojnë ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha cikleve të studimit.<br><br>*Reference:Evidenca An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021*<br><br>*Reference: An._1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi_2022; An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB.*<br><br>*Evidenca An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf;*<br><br>*Evidenca Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi Bachelor në "Menaxhim Biznesi" ofrohet nga Departamenti i Menaxhim Biznesi, një nga 2 departamentet e Fakultetit të Ekonomisë, që nga viti 2020 në zbatim të Urdhërit Nr.204 prot. date 03.07.2020, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si riorganizim i programit 4 vjeçar Bsc. Menaxhim Biznesi, hapur me VKM nr. 274, date 10.05.2006.<br><br>Njësia bazë ka përvojë të mjaftueshme dhe cilësore për të ofruar këtë program, përvojë që rrjedh sa nga e kaluara dhe tradita e institucionit, aq edhe nga niveli profesional dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe bashkëpunimet me institucione të tjera të njohura si brenda dhe jashtë vendit.<br><br>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përbëhet nga 22 pedagogë, nga të cilët 75% janë me kohë të plotë (17 pedagogë) dhe 25% me kohë të pjesshme (5 pedagogë). |

| | |
|---|---|
| | 36% e stafit mbajnë titujt Prof.Dr dhe Prof.Asoc.Dr. 8 pedagogë, përkatësisht 5 të brendshëm dhe 3 me kohë të pjeshme. 36% e stafit mbajnë gradën shkencore Doktor, përkatësisht 6 të brendshëm dhe 2 me kohë të pjeshme. Gjithashtu, 2 pedagogë të brendshëm janë në proces për marrjen e gradës shkencore Doktor. Me titullin Msc. janë 18% e stafit të brendshëm ( 4 pedagogë).<br><br>GVJ gjykon që njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie bazuar tek trajnimet profesionale të stafit, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit që IAL ndjek për marrjen e stafit të ri, raportimin e punës kërkimore shkencore si dhe analizën vjetore të departamentit mbi arrijtjen e objektivave të programeve të studimit.<br><br>*Reference:Evidenca An._3_13_ Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim në programin MB..pdf; An._3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MB..pdf; An._3_26_Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi..pdf*<br><br>*Reference: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf*<br><br>*Evidenca: An._1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkvit.pdf; An._1_6_1_Proçedurat e emërimit të stafit akademik në KUQ.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe | GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore. Struktura e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është e organizuar sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në VKM nr. 41 datë 24.01.2018 dhe ndryshimeve të përcaktuara për të (VKM nr.185 datë 25.03.2021). Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në proces akreditimi është Departamenti i Menaxhim Biznesi, ndërsa njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë. GVJ gjykon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit. |

| | |
|---|---|
| udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Bazuar në rregulloren e Qëndrës Kërkimore Shkencore si njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, veprimtaria e saj bazohet në strategjinë e kërkimit shkencor në përputhje me politikat dhe objektivat e këtij fakultetit. Kjo veprimtari shtrihet në fushat sociale dhe ekonomike humaniste për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor. Gjithashtu, kjo qëndër kujdeset dhe për kërkimet për hapjen e programeve të studimit në Fakultetin e Ekonomisë. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi synon të formojë specialistë në fushën e menaxhimit të biznesit si në sektorin privat edhe në atë publik.<br><br>Në dokumentin Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional, në pikën 1.4, fq.10 specifikohen shtyllat kryesore mbi të cilat IAL do të mbështesë aktivitetin e tij në përmbushje të misionit dhe vizionit për programet e ofruara të studimit sipas strategjisë së planifikuar për periudhën 2021-2026.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi se njësia kryesore analizon në mënyrë të vazhdueshme punën kërkimore shkencore dhe rezultatet e saj. GVJ do të sugjeronte përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit. Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit IAL ka përgatitur propozimin për variantet e kodeve të programeve të studimit në përputhje me përcaktimet ngaVKM-së nr.310 datë 11.05.2022.<br><br>*Reference:An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; An._2_5_ Rregullore e Qëndrës së Kërkimit Shkencor të FE*<br><br>*Evidenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB.*<br><br>*Reference: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf*<br><br>*Reference: An._3_34_ Propozimi i Komisionit mbi variantet e kodeve të programeve në KUQ.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të KUQ u konstatua se programi Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përbën risi në ofertën akademike të* |

| | |
|---|---|
| | *fakultetit, të transformuar për t'ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.*<br><br>*GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore.*<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumentacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi I.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi", Departamenti i Menaxhim Biznesi, si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e lëndëve bazë të programit mbulohen nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm i Departamentit (30 %), ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të KUQ që mbulon një pjesë të konsiderueshme të lëndëve të programit.<br><br>GVJ gjykon se nevojitet një pjesëmarrje më e konsiderueshme e stafit të Departamentit në programin e studimit. Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" lejon bashkërendim të stafit në disa disiplina formimi, si ekonomiksi, financa dhe kontabiliteti, informatika, statistika, etj. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të KUQ duke filluar nga Rektori, Dekani, Pergjegjësi i Departamentit, NJZHKSC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e KUQ. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi*<br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë;*<br>*Reference: Evidenca An._1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"; An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf;*<br>*Referenca: An._3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MB;. An._3_10_Stafi akademik i Departamentit të Menaxhim Biznesit.*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marëdhënie bashkëpunimi. Institucioni, ka ndërmjetësuar 34 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF) të cilët japin një kontribut tepër të vyer për lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës, nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore si dhe institucione të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Në dokumentin Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi", tek çështja 2.4. Ndërkombëtarizimi IAL specifikon se KUQ synon të forcojë rrjetet aktuale dhe krijimin e rrjeteve të reja të institucioneve bashkëpunuese kombëtare dhe ndërkombëtare që promovojnë dhe mbështesin procesin mësimor dhe kërkimin shkencor nëpërmjet projekte të përbashkëta, pjesëmarrjes në konferenca shkencore të përbashkëta, organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kërkimore të përbashkëta dhe programeve të shkëmbimit të eksperiencave profesionale. Gjithashtu angazhimi në marrëshje bashkëpunimi me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike të praktikave mësimore, kërkimit dhe konsulencës ndaj të tretëve. Në përputhje me Planet strategjike të zhvillimit të Fakultetit Ekonomik dhe të Zhvillimit të Programit të Studimit (fq.8-9), Departamenti dhe të gjithë anëtarët e stafit mund të përfshihen në bashkëpunime nëpërmjet shkëmbimit të përvojave akademike, pjesëmarrjes në kërkime dhe projekte të përbashkëta, pjesëmarrje në konferenca dhe shkencore të përbashkëta organizimin e seminareve të përbashkëta dhe propozimeve për këmbimin e publikimeve me qëllim pasurimin e bibliotekës. |

| | |
|---|---|
| | *Reference: An.1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"; An.2_2_Plani Strategjik i Zhvillimit të FE.pdf; An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB;*<br><br>*Referenca: An._3_16_ Rregullore e praktikës profesionale; An. 3_18_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MB.*<br><br>*Referenca: An.3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB.*<br><br>*Referenca: An._2_18_Ekspertizë e ofruar nga ana e pedagogve të FE për të tretë.pdf; 17.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf; 17.An._3_33_ Mobilitete me Universitetet e Jaen-it në Spanjë dhe Azerbajxhanit..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Në sajë të marëveshjeve të bashkëpunimit të arritura nga institucioni Njësia përgjegjëse për programin mundëson realizimin e praktikave të studentëve. GVJ konstaton se mbikqyrja e praktikës gjithashtu realizohet në mënyrë të institucionalizuar në sajë të dokumentacionit tip të parapërgatitur (Model i dosjes së praktikës profesionale) i cili plotësohet nga mbikqyrësi dhe pedagogu përgjegjës përgjatë realizimit të praktikës mësimore.<br><br>Institucioni ka vendosur zgjatjen e praktikës mësimore me 5 javë në semestrin e 6-të të studimeve të programit, e cila mundësohet në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit që ka vendosur institucioni. Takimi me studentët konfirmoi vlefshmërinë e praktikave mësimore, të cilat ju shërbejnë atyre për të fituar shprehitë e para të punës praktike si edhe njohjen me tregun e punës. GVJ vlerëson se në drejtim të praktikave mësimore, rrjeti i bashkëpunimeve të njësisë përgjegjëse për programin, përbën një avantazh.<br><br>*Referenca: An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB;*<br><br>*Referenca: An._3_16_ Rregullore e praktikës profesionale; An. 3_15_ Model i dosjes së praktikës profesionale.pdf; An. 3_18_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MB.*<br><br>*Referenca: An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB.* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Krahas marrëveshjeve të bashkëpunimit, KUQ organizon panairin e punës me pjsëmarrjen e bizneseve nga sektorë të ndryshëm ku shërben si një urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe tregut të punës. Njësia përgjegjëse për programin e studimit – Departamenti i Menaxhimit të Biznesit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi".<br>*Referenca: An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB; An. 3_36_Raport mbi panairin e punës.*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi", Departamenti i Menaxhim Biznesi, si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Nga ana tjetër GVJ gjykon se nevojitet një pjesëmarrje më e konsiderueshme e stafit të Departamentit në programin e studimit.*<br>*GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marëdhënie bashkëpunimi. Në drejtim të praktikave mësimore, GVJ vlerëson se rrjeti i bashkëpunimeve të njësisë përgjegjëse për programin, përbën një avantazh.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br><br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit është hapur me VKM nr. 274 datë 10.05.2006, në mbështetje të nenit 1, 12 & 13 të ligjit numër 8461 datë 25.02.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi" Sipas këtij Vendimi, programi i studimit Menaxhim Biznesi ofrohej nga Fakulteti Ekonomik, tituli i lëshuar i diplomës për këtë program studimi "Menaxher Biznesi", ofruar me një sistem studimi me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje 4 vite akademike.<br><br>Me UMAS nr.369, datë 12.11.2009 institucioni ka marrë akreditimin e parë të programit të studimit Menaxhim Biznesi, por janë hequr kushtet me VKA nr. 89 datë 03.09.2010. Me VBA nr. 103 datë 02.11.2019 institucioni ka marrë vlerësim pozitiv për një vit për programin e studimit bachelor në "Menaxhim Biznesi" me kohëzgjatje 3 vite dhe 180 ECTS. Sipas urdhërit të MAS nr. 204 datë 03.07.2020 Institucionit i është kërkuar riorganizmi i këtij programi studimi me kohëzgjatje 3 vite/ 6 semestra ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë në Kolegjin Universitar "Qiriazi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare Bachelor në Menaxhim Biznesi.<br><br>Programi është i organizuar në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), konkretisht si një sistem studimi me kohë të plotë, me 180 ECTS, me kohëzgjatje 3 vite akademike. Sipas planit mësimor ky program përbëhet nga<br><br>• Lëndë Bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (4 lëndë/module/31 ECTS/ 17%);<br>• Lëndë Karakterizuese- përgatitje për disiplinën shkencore (14 lëndë/module /97 ECTS/ 54%);<br>• Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese- ndërdisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje (4 lëndë/module /26 ECTS/ 14%);<br>• Lëndë Plotësuese- gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale (4 lëndë/module/19 ECTS/ 11%); |

| | |
|---|---|
| | • Detyrimet Përmbyllëse-Provim Diplome/7 ECTS/4%);<br><br>Plani mësimor është i organizuar në 6 semestra të shpërndarë në tre vite akademike, me lëndë e module të vlerësuara me kredite. Në plan pasqyrohen 27 lëndë me 29 module. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e një provimi të përgjithshëm formimi ose të përgatitjes dhe mbrojtjes të një punimi diplome, në varësi të notës mesatare (*Neni 16- Prova finale Evidenca 3 Rregullore e programit te studimit*).<br><br>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Neni 9, 10 & 11)*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.*<br><br>*Referenca: An._1_1_1_Akte nënligjore për KUQ.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë | GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t'iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi synon të formojë specialistë në fushën e menaxhimit të biznesit si në sektorin privat edhe në atë publik, me nivel të lartë në aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale, si dhe t'i përgjigjen sfidave të zhvillimit të shoqërive tregatre në kushtet e konkurrencës. |

| | |
|---|---|
| akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Përcaktimi i rezultateve të të nxënit në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta. Rezultatet e të nxënit të pasqyruara tek silabuset përkatëse të lëndëve të ofruara nga programi i studimit janë të shprehura në terma të njohurive, aftësive dhe kompetencave që përfiton studenti. Nga ana tjetër nevojitet që këto rezultate të të nxënit të programit të studimit të pasqyrohen dukshëm edhe në dokumentin që përcakton strategjinë e<br><br>zhvillimit të këtij programi studimi. Në përpjekje për tu përshtatur dhe përditësuar me kërkesat dhe trendet e tregut të punës si dhe të fushës së studimit, departamenti si njësi bazë e programit të studimit përditëson në mënyrë periodike listën e librave në bibliotekë.<br><br>*GVJ gjykon që programi duhet të garantojë llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh, duke mos u fokusuar dhe profilizuar në drejtim të financës, siç vihet re dhe nga pesha që zënë lëndët me karakter financiar në kurrikulën e këtij programi studimi.*<br><br>Nga këndvështrimi i studentëve të regjistruar në këtë program studimi, lëndët e përfshira në këtë program, përmbajtja e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Menaxhimit, e cila përforëcohet nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe nga organizatat publike dhe operatorët e biznesit.<br><br>GVJ gjykon që njësia kryesore është e paisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Neni 9, 10 & 11); An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB.*<br><br>*Referenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf; Referenca: .An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve..pdf; An._3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB..pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek Plani mësimor edhe Rregullorja e programit të studmit, lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmëndja që i kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>Programi që po vlerësohet, është organizuar:<br>• 31 ECTS ose 17 %, lëndë bazë (kategoria A);<br>• 97 ECTS ose 54%, lëndë karakterizuese (kategoria B);<br>• 26 ECTS ose 14%; lëndë integruese, ndërdisiplinore dhe me zgjedhje (kategoria C);<br>• 19 ECTS ose 11%, lëndë plotësuese (kategoria D);<br>• 7 ECTS ose 4%, detyrime përmbyllëse (kategoria E);<br><br>GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore. GVJ gjykon që program i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Neni 9, 10 & 11)*<br><br>*Referenca: An._3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*Referenca: An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës | Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është i organizuar në module të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, të ngjashëm dhe/ose integrues si edhe module formuese me zgjedhje, përveç praktikës mësimore profesionale |

| | |
|---|---|
| profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | dhe përgatitjes së diplomës, të cilat e kanë të përcaktuar qartë përmbajtjen e tyre, mënyrën e organizimit si edhe format e mësimdhënies.<br><br>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi përcakton ngarkesën në kredite lidhur me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, specifikisht tek kategoria D (19 ECTS ose 11%) - lëndë plotësuese ku përfshihet Praktikë pranë Sipërmarrjes dhe tek kategoria E (7 ECTS ose 4%) detyrime përmbyllëse, në përputhje me specifikimet ligjore.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | KUQ është një institucion jo-publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. GVJ konstaton se forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Në kreun II të rregullores së programit të studimit përcaktohen kriteret e pranimit të studentëve, dokumentacioni, regjistrimi dhe matrikullimi. Kurse financimi bazohet tek burimet e brendshme të administratorit dhe tek të ardhurat e tarifave të studimit.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An._1_17_ Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Unive.pdf*<br><br>*Referenca: An._3_21_1_ Plani i financimit të programit të studimit MB..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të | Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit që po akreditohet. |

| | |
|---|---|
| ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Bazuar në VKM nr.310 datë 11.05.2022 "Për përmbajtjen e kodifikimit të programeve studimore në IAL" dhe UMAS nr.31 datë 15.11.2022 "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", për programin e ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Menaxhim Biznesi" KUQ ka propozuar kodin 63BA0413S.<br>*Referenca: An._3_34_ Propozimi i Komisionit mbi variantet e kodeve të programeve në KUQ..pdf*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | KUQ nuk ofron programe të ciklit të parë të studimit, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, si diploma të përbashkëta midis institucioneve të arsimit të lartë vendas apo të huaj.<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon që njësia kryesore është e paisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit.*<br>*Megjithatë programi duhet të garantojë llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh, duke mos e anuar programin më tepër në fushën e financës. Gjithashtu GVJ gjykon që program i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| |
|---|
| **Standardi II.2** |
| **Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** |

<table>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</td>
<td>Fakulteti i Ekonomisë pranë KUQ është Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit në akreditim. Ky fakultet është krijuar me me VKM nr. 274 datë 10.05.2006 " "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi". Me UMAS nr. 92 datë 01.03.2017 për "Miratimin e Statutit të Kolegjit Universitar "Qiriazi" dhe UMAS nr. 362 datë 23.12.2020 për "Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazi" kjo njësi kryesore përbëhet nga tre njësi bazë:
<ol>
<li>Departamenti i Menaxhim Biznesi;</li>
<li>Departamenti i Financës;</li>
<li>Qendër Kërkimore Shkencore FE;</li>
</ol>
Organizimi dhe strauktura e fakultetit është në përputhje të plotë me nenin 23 të Ligjit 80/2015. IAL është riakredituar sipas VBA nr.24 datë 01.05.2018 dhe më pas sipas VBA nr.52 datë 09.09.2022. Struktura akademike përputhet plotësisht me misionin, qëllimin dhe objektivat e Programit që vlerësohet. Organizimi i saj mbështet plotësisht aktivitetin akademik si edhe operacional. Stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Departamenti për tre vite akademike ka në përbërjen e tij staf si më poshtë:
<table>
<tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>2</td></tr>
<tr><td>Dr./PhD.</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>4</td><td>-</td><td>4</td><td>1</td><td>4</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>7</td><td>3</td><td>7</td><td>3</td><td>7</td><td>2</td></tr>
</table>
Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përbëhet nga 22 pedagogë, nga të cilët 75% janë me kohë të plotë (17 pedagogë) dhe 25% me kohë të pjesshme (5 pedagogë). 36% e stafit mbajnë titujt Prof.Dr dhe Prof.Asoc.Dr. 8 pedagogë, përkatësisht 5 të brendshëm dhe 3</td></tr>
</table>

me kohë të pjeshme. 36% e stafit mbajnë gradën shkencore Doktor, përkatësisht 6 të brendshëm dhe 2 me kohë të pjeshme. Gjithashtu, 2 pedagogë të brendshëm janë në proces për marrjen e gradës shkencore Doktor. Me titullin Msc. janë 18% e stafit të brendshëm ( 4 pedagogë).

Referuar ngarkesës mësimore dhe stafit akademik që e mbulon, rezulton se 81% mbulohet nga përsonel akademik efektiv dhe 19 % të ngarkesës totale, mbulohet nga përsonel akademik me kontratë.

| Viti | Total orësh | PAE | PAK | PAE/PAK (%) |
|---|---|---|---|---|
| 2022-2023 | 1665 | 1480 | 180 | 89 % / 11% |
| 2021-2022 | 1665 | 1515 | 150 | 91%/9 % |
| 2020-2021 | 1665 | 1275 | 390 | 77%/23% |

Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm professional dhe shekncor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:

- Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia.
- Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Pjesëmarrjes në projekte
- Shkëmbimeve akadmeike nëpërmjet projektit Erasmus.

Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfitues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.

GVJ, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush *kryesisht* detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf.*<br><br>*Reference:An._3_13_ Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim në programin MB..pdf; 7.Stafi akademik me ngarkesen mesimore, per tre vitet e fundit.pdf; An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br><br>*Referenca: An._1_1_1_Akte nënligjore për KUQ.*<br><br>*Referenca: . An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf; An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve..pdf; 7.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf;* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Në perputhje me specifikat e planit të studimit, departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në procesin e zhvillimit të praktikave mësimore harton programin e praktikës profesionale si dhe cakton personelin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në institucionin apo biznesin e caktuar. Për këtë program studimi ky kriter nuk aplikohet pasi per praktikat mësimore angazhohet personel akademik, ndërsa programi i studimit nuk përfshin praktika laboratorike e klinike.<br><br>*Referenca: An.3_16_ Rregullore e praktikës profesionale.* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njësisë bazë, veçanërisht i Rregullores së programit të studimit (neni 25), konfirmojnë se koordinatori i departamentit menaxhon veprimtarinë e programit të ciklit të parë të studimeve ne Fakultetin e Ekonomisë dhe asiston Përgjegjësin e Departamentit për mbarëvajtjen dhe realizimin e punëve në departament. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KUQ (Vendimi nr. 10 datë 11.10.2022 për caktimin në detyrë të koordinatorit të programit të studimit Bachelor në Menaxhim) koordinatori i departamentit emërohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit. GVJ vëren se koordinatori përgjegjës për programet e studimit që mbulon njësia bazë ka rolin të asistojë përgjegjësin e departamentit për organizimin, koordinimin dhe mbikqyrjen e punës për zhvillimin e programeve të studimit, si dhe ndihmon studentët me sugjerime për përgatitjen e punimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | diplomës, për zhvillimin e praktikës profesionale dhe orientimin e tyre për tregun e punës.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij.pdf* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br><br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullatore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (VKM nr. 274 datë 10.05.2006" "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi"; UMAS nr. 92 datë 01.03.2017 për "Miratimin e Statutit të Kolegjit Universitar "Qiriazi" dhe UMAS nr. 362 datë 23.12.2020 për "Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazi"; Akreditim periodik pozitiv i IAL-së me VBA nr.24 datë 01.05.2018 dhe më pas me VBA nr.52 datë 09.09.2022; Akreditimi pozitiv për një vit me VBA nr. 103 datë 02.11.2019 për programin e studimit bachelor në "Menaxhim Biznesi")<br><br>Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit të Biznesit, përgjegjës për programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi", disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.<br><br>Mbi bazën e legjislacionit udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të |

| | |
|---|---|
| | Arsimit të Lartë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel fakulteti dhe më tej, departamenti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet. Rregullorja e brendshme e departamentit (Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit) dhe Rregullorja e Fakultetit (Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë), të cilat miratohen me Vendim të Senatit Akademik, përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet e departamentit me studentët. GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni.<br><br>*Referenca: An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021 An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf. An._1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"*<br>*Referenca: An._1_1_1_Akte nënligjore për KUQ*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të KUQ 2021-2026, si edhe në Planet mësimore vjetore. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Menaxhim Biznesi. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.<br><br>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit (Kreu IV- & Kreu VI), Rregulloren e programit (Kreu II & III) janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë. |

| | |
|---|---|
| | Vlerësimi i dijeve të studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar është deri në masën 40% të totalit të pikëve dhe konsiston në elementët e mëposhtëm:<br>▪ Aktivizimi dhe pjesëmarrja në seminare;<br>▪ Testi i ndërmjetëm (detyra kontrolli) dhe<br>▪ Detyrë kursi ose ese<br>Frekuentimi leksioneve në këtë program studimi është i rekomanduar deri në masën 50% ndërsa frekuentimi i ushtrimeve/seminareve/praktikave/ është i detyrueshëm në masën 80%.<br><br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"*<br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Institucioni ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: Rregullorja e Programit Bachelor në "Menaxhim Biznesi", Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si edhe Statuti i KUQ.<br>Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, transferimi i studimeve, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bachelor në "Menaxhim Biznesi". Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit janë në përputhje me nenin 74 te ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, me udhëzimet e përvitshme të MASR, të cilat miratohen me vendim Senati Akademik. Këto kritere parashikohen në Rregulloren e programit të studimit sipas nenit 6. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | Çështjet e mësipërme i gjejmë të specifikuara në Rregulloren e Departamentit (Kreu V – Kontrolli i dijeve, Kreu VIII – Transferimet, ndërrimi i sistemit të studimeve), Rregulloren e programit të studimit, (Kreu II & Kreu III) si dhe ne dokumentin "Mbi organizimin dhe drejtimin e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Procesi i pranimit të studenteve bëhet mbi bazë të një transparence të plotë, ku kriteret e pranimit, afatet, lista e kandidatëve fitues etj. shpallen në faqen zyrtare të IAL-së dhe mjetet e tjera në dispozicion të informimit.<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf*<br>*Refrenca: An._1_25_ Kriteret e pranimit të studentëve.pdf*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t'u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Formati i syllabuseve përputhet me standardet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.<br>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e pare të mësimit. GVJ konstaton se programet e lëndore përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 4.<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit | Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut, departamenti si njësia bazë përgjegjëse për programin e |

| | |
|---|---|
| është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | studimit, përpjekjet për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të programit të studimit i bën pjesë pjesë të planit vjetor të punës së departamentit. Stafi akademik brenda vitit akademik aktual bën propozimet tek përgjegjësit e gruplëndës përkatëse mbi ndryshimet në module apo syllabuse dhe në renditjen e tyre me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programi të studimit. Pas analizës së bërë nga përgjegjësi i grup lëndës mbi nevojën e ndërhyrjes për këto ndryshime për ndryshime, propozimet diskutohen nga përgjegjësi i departamentit në mbledhjen e radhës përpara fillimi të vitit akademik dhe vendimi mbi propozimet merret me shumicë votash. Vendimi final për ndryshimet e propozuara i takon Dekanit të Fakultetit. Gjithashtu, bazuar në rregulloren e regulloren përkatëse dhe manualin e cilësisë si dhe sipas vizitës në institucion, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka detyra thelbësore për të mbështetur procesin e përmirësimit dhe përditësimit tv vazhdueshëm të programit të studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se ka nevojë për përditesimin e tyre me literaturë bashkëkohore.<br><br>*Refrenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf An._3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2021-2022. pdf; An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf*<br><br>*Rferenca: An._2_19_Udhëzim mbi ndyshimet në syllabus, lëndë dhe programe; An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit.* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmëndje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni. Gjithashtu, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të KUQ 2021-2026, si edhe në Planet mësimore vjetore.*<br><br>*GVJ konstaton se programet lëndore të këtij programi studimi përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme.*<br><br>*Megjithatë kërkohet një përditësim i syllabuseve/moduleve të këtij programi studimi me literaturë bashkëkohore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi që po vlerësohet, Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.<br>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshem) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues. Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Zhvillimi i praktikës mësimore gjatë një semestri ka ndikuar në rritjen e efektivitetit të tyre.<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB; An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br>*Referenca: An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit; An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve. pdf;*<br>*Referenca: An._3_18_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MB..pdf; An._3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB..pdf* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e | Siç konstatohet nga Plani mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të |

| | |
|---|---|
| semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | përshkallëzuara. Kështu, në vitin e pare dhe të dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të përgjithshme, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale.<br><br>Planet mësimore si edhe dokumentat plotësuese sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB; An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion34* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit dhe të programit të studimit konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në "Menaxhim Biznesi", në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si specialistë dhe menaxherë për kompani e organizata të ndryshme publike dhe private.<br><br>Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës. Plani mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kritereve të standardit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit kryesisht realizohen në vitin e tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e Përgjithshëm Përfundimtar. Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruara, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përftuar. GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare. |
| | |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB; An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion34* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Objektivat formuese të programit, të specifikuara tek Rregullorja e Programit dhe Rregullorja e Departamentit, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor. Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluara në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Menaxhim Biznesi. Strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB;*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion34* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperienca e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme. Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik duke përfshirë literaturën, metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies, etj. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës. |

| | |
|---|---|
| | *Megjithatë, siç përmendet edhe në Standardin II.3, Kriteri 5, përditësimi i syllabuseve duhet të marrë parasysh përfshirjen e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi menaxhimin e organizatave të ndryshme publike dhe private, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin financiar etj, *megjithatë GVJ gjykon që programi duhet të përfshijë më tepër shumëllojshmëri njohurish që lidhen me fushën e meanxhimit të biznesit dhe jo duke u fokusuar dhe profilizuar në drejtimin financiar.*<br><br>Njësia bazë konsideron nevojë parësore analizën e vazhdueshme të tregut, të cilën e ka realizuar dhe e ka përdorur për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies si edhe rritur efektivitetin e studimeve akademike, por nevojitet një analizë që nxjerr ne pah nevojat aktuale të tregut të punës, aftësitë që kërkohen më tepër për të cilët nevojitet përgatitja e studentëve që do të dalin së shpejti në tregun e punës.<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Refrenca: An._3_6_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Nisur nga:<br>▪ Objektivat formuese të programit;<br>▪ Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese;<br>▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike;<br>▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës;<br>▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies;<br>▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit<br>Nëpërmjet rregullores për praktikën profesionale dhe dosjen e saj, IAL ka specifikuar mënyrën e zhvillimit të praktikës pranë institucioneve private dhe publike si dhe rolin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë process formues qe shërben si një urë lidhëse për studentin për të integruar teorinë e në auditor me praktikën konkrete që shfaq tregu i punës.<br>*<u>GVJ sugjeron</u> se IAL duhet të realizojë takime me bordin e tregut të punës, Alumni për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.*<br>Njësia bazë i kushton vëmëndje të veçantë përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus. GVJ mbështet përfundimin se program i studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve si dhe punësimin e studentëve në përshtatje deri diku me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.<br>*<u>Gjithsesi GVJ</u> mbetet në gjykimin se IAL duhet të sigurohet që programi i studimit garanton llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh në fushën e menaxhimit të organizatave duke kapërcyer fokusin vetem në drejtim financiar.*<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Refrenca: An._3_6_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*Referenca: An._3_16_ Rregullore e praktikës profesionale..pdf*<br><br>*n._3_15_ Model i dosjes së praktikës profesionale..pdf* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës dhe se struktura e tij i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare. Gjithashtu, strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.*<br><br>*Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi menaxhimin e organizatave të ndryshme publike dhe private, por nevojitet që programi i studimit të përfshijë më tepër shumëllojshmëri njohurish që lidhen me fushën e meanxhimit të biznesit dhe jo të fokusohet dhe profilizohet në drejtimin financiar. Për këtë nevojitet një analizë më e detajuar e tregut të punës që nxjerr ne pah nevojat aktuale të ttij apo aftësitë që kërkohen më tepër. Gjithashtu nevojitet përfshirja e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë.*<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> se IAL duhet të realizojë takime me bordin e tregut të punës, Alumni për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| **Standardi II.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Departamenti i Menaxhim Biznesi, si njësi bazë e programit të studimit implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Lidhur me aktorët e brendshëm departamenti në bashkëpunim me Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë realizon pyetësorin me studentët dy herë në vit, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB. Megjithatë<br><br>*GVJ rekomandon që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumente të tjerë në funksion të përmirësimit të programit, psh zhvillimi i fokus grupeve si instrumente për të matur përceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi, nëse pyetësorët nuk e ofrojnë këtë informacion.*<br><br>Këndvështrimet e aktorëve të tjerë si institucionet partnere, konkurenca dhe ecuria e dinamikës së tregut janë pjesë e analizës së tregut që bën institucioni si dhe pjesë e analizës që i paraprin formulimit nga ana e institutcionit të strategjisë për zhvillimin e programit të studimit. Gjithashtu integrimi i eksperiencave Erasmus të stafit dhe studentëve është një instrumentë tjetër që i shërben procesit të përmirësimit dhe përshtatjes së programit të studimit. *Megjithatë GVJ gjykon përfshirjen e mendimit/opinionit dhe të bordit të tregut të punës, Alumni të cilët nëpërmjet eksperiencave të tyre në tregun e punës pas diplomimit në këtë IAL do të ndihmonin në identifikimin e ndërhyrjes për përmirësim në këtë program studimi.*<br><br>*Refrenca: An._3_6_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*An._3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB..pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit;*<br><br>*Refrenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf; An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf;An._3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë(NJSBC) viti akademik 2021-2022..pdfAn._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen..pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në statutin e IAL (Neni 47 & 48) gjejmë të pasqyruar përfshirjen e studentëve dhe integrimi i mendimit të tyre nëpërmjet pjsëmarrjes së përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese dhe në proceset e vendimmarrjes të KUQ. Siç përmendet edhe në kriterin e mësipërm pyetësorët me studentët (dy herë në vit), si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB përfaqëson një tjetër formë të përfshirjes së studentëve. *Megjithatë, GVJ gjykon përfshirjen e mendimit/opinionit dhe të bordit të tregut të punës, Alumni të cilët nëpërmjet eksperiencave të tyre në tregun e punës pas diplomimit në këtë IAL do të ndihmonin në identifikimin e ndërhyrjes dhe reflektim për përmirësim në këtë program studimi.*<br><br>*An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021*<br><br>*Refrenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf; An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf;An._3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë(NJSBC) viti akademik 2021-2022..pdfAn._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen..pdf*<br><br>Referenca: An._3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë..pdf |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe | Bashkëpunimi dhe marrëdhënia e qëndrueshme me institucionet partnere nga tregu i punës me të cilat IAL KUQ ka marrëveshje krijojnë mundësinë që Departamenti si njësia bazë përgjegjëse për përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen e programit të studimit të marrë feedbackun e duhur për të ndërmarrë strategjitë dhe hapat e duhur drejt procesit të përditësimit me ndryshimet e kërkuara. *Megjithatë nevojitet dhe mendimi/opinioni i bordit të tregut të punës, Alumni në këtë proces.* |

| | |
|---|---|
| institucione publike e private. | *Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion*<br><br>*Referenca: An._3_18_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MB..pdf; An._3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB..pdf* |
| **Konkluzione** | *IAL implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Megjithatë GVJ gjykon që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumente të tjerë në funksion të përmirësimit të programit të studimit si dhe përfshirjen e mendimit/opinionit të bordit të tregut të punës, Alumni që do të ndihmonte në identifikimin e ndërhyrjes dhe reflektimit për përmirësim në këtë program studimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët | Në programin e studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë:<br>✓ Leksionet (945 orë totale në auditor)<br>✓ Seminaret (720 orë totale në auditor)<br>✓ Detyra Kursi/Ese |

| | |
|---|---|
| laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | ✓ Praktika profesionale<br>✓ Leksionet e hapura<br>Ndërsa tre të parat janë pjesë e vlerësimit të lëndës, dy të fundit shërbejnë për konsolidimin e njohurive teorike dhe nëpërmjet tyre, krijimin e shprehive praktike.<br>Këto metoda kryesore të mësimit janë përcaktuar edhe në dokumentat: Rregullore e programit te studimit dhe syllabuset e lëndëve. Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si: Plani strategjik i zhvillimit te programit te studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, Analiza vjetore e departamentit dhe Udhëzuesi për kualifikimin e stafit akademik, por edhe në takimet e GVJ me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit.<br>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimit, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimit të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për t'iu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.<br>*Referenca: An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB.pdf An._3_7_Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf; An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi*<br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br>*Referenca: An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi | Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve. Programi Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përfshin format e mësimit teorik e praktik si leksionet, seminaret, ushtrimet, detyrat e kursit apo ese. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve |

| | |
|---|---|
| alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës.<br><br>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik.<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB.pdf An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf; An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didatike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve.<br><br>Institucioni mundëson kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik si brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik angazhohet në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit, ku nëpërmjet vizitave dhe shkëmbimeve në institucionet e huaja universitare, u mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.<br><br>*Refrenca: An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf An._3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf.*<br><br>*Referenca: An._1_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin-shkencore të stafit akademik të* |

| | |
|---|---|
| | *KUQ.pdf An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf; An._3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja..pdf; 17.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Refrenca: An.1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Nga shqytrimi i dokumentacionit të personelit akademik, të angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. Rezultatet e punës kërkimore shkencore paraqiten në botime brenda dhe jashtë vendit.<br><br>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase.<br><br>Metodat interaktive të mësimdhënies përqëndrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërrmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj. Bashkëpunimi i ndësjelltë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte kërkimi edhe në mbikqyrjen e praktikës mësimore, realizimi i të cilës mundësohet në sajë të kontakteve dhe bashkëpunimeve të Institucionit me institucionet publike dhe jo publike. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf; An._1_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin-shkencore të stafit akademik të KUQ.pdf An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf;*<br><br>*Refrenca: An._3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja..pdf; 17.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf; An._3_12_ CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit MB..pdf*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Refrenca: An.1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Institucioni ka ndërtuar disa instrumenta që përdoren për përmirësimin e veprimtarisë mësimore. Strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin si dhe njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrolle të zhvillimit të mësimit, aplikimin e pyetsorëve si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të përformancës së stafit akademik në disa fusha, etj. Vëzhgimi nga afër i mënyrës së kryerjes së mësimit, vecanërisht për personelin akademik lektorë dhe asistentë lektorë, lejon të japin mendime e sugjerime, si dhe shkëmbejnë eksperienca. Performanca e personelit akademik vlerësohet edhe duke marrë shqetesimet apo sugjerimet e studentëve, përmes ppyetësorëve anonimë dhe bisedave që realizohen në mbledhjet e hapura të ddepartamentit.<br><br>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj.<br><br>GVJ konstatoi se zyra e NJSBC, harton një raport vjetor me rezultatet e pyetësorëve të përdorur, atë të studentëve, të studentëve para diplomimit si dhe të pedagogëve. GVJ konstaton se raporti nuk identifikon në mënyrë specifike |

| | |
|---|---|
| | analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Rekomnadimet janë përgjithshme dhe nuk iu referohet gjetjeve të pyetësorëve por të dhënave sekondare. Pavarësisht sa më sipër, nga vizita në institucion, GVJ nuk konstatoi praktika të shpërndarjes së vlerësimit të pyetësorëve tek stafi.<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyërë konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjitshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara.*<br><br>*Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf;*<br><br>*Rferenca: An.3_20_ Pyetësorët e studentëve.pdf; An.3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen.pdf; An.3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.pdf An.3_32_Pyetësor për Pedagogun..pdf;*<br><br>*Refrenca: An.3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2021-2022.pdf; An.3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf An.1_7_1_Kriteret e vlerësimit të stafit akademik.pdf*<br><br>*Refrenca: An.1_7_4_Pyetësor për mbi performancën e stafit akademik të KUQ.pdf An.1_12_Model i vlerësimit të perfomancës së pedagogut.pdf* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhc zhvillimin e metodave të reja inovative të | Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se KUQ, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit dhe rregullores së KUQ si dhe rregullores së NJSBC.<br><br>Gjithashtu, Institucioni mundëson trajnime të ndryshme për personelin akademik që synojnë njohjen dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Nga ana tjetër edhe pjesëmarrja në mobilitete sjell praktika të reja mësimdhënie, të |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | cilat ndahen dhe diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.<br><br>*Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf;*<br><br>*Rferenca: An.3_20_ Pyetësorët e studentëve.pdf; An.3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen.pdf; An.3_27; Pyetësor për Pedagogun.pdf;*<br><br>*Refrenca: An.3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2021-2022.pdf; An.3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë..pdf An._1_7_1_Kriteret e vlerësimit të stafit akademik.pdf*<br><br>*Refrenca: An.1_7_4_Pyetësor për mbi performancën e stafit akademik të KUQ.pdf An.1_12_Model i vlerësimit të perfomancës së pedagogut.pdf*<br><br>*Refrenca: An.1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*An._3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja..pdf; 17.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf.* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didatike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore.*<br><br>*Fusha e ekspertizës dhe kërkimore shkencore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.*<br><br>*Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. <u>GVJ konstatoi</u>, se raport vjetor i zyrës së NJSBC nuk identifikon në mënyrë specifike analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Rekomnadimet janë përgjithshme dhe nuk iu referohet gjetjeve të pyetësorëve.*<br><br>*Gjithashtu <u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyërë* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjitshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktura në rregulloret përkatëse. Vizita në instucion, veçanërisht diskutimi me studentët konfirmoi vlerësimin se të gjitha kriteret dhe rregullat e mënyrat e testimit janë të njohura në sajë të publikimit në faqen e institucionit të planit mësimor, në syllabusin e lëndës si edhe informimit e sqarimit nëpërmjet strukturave të institucionit.<br><br>GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve është i vazhdueshëm duke përfshirë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, provimi final i lëndës dhe provimi i përgjithshëm i formimit/mbrojtjediplome.<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Kreu V-Kontrolli i Dijeve); An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Kreu III- Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijeve; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MB.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në vijim të informacionit të dhënë tek kriteri 1 i këtij standardi, GVJ vlerëson se pedagogët i informojnë studentët në fillim të procesit mësimor me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulin përkatës. Gjithashtu progarmet e lëndëve, përfshirë edhe elementët e mësipërm janë pjesë e publikimit të secilit pedagog, në faqen përkatëse të sistemit të menaxhimit të të dhënave SMI. Përveç sistemit, institucioni për komunikim interaktiv dhe zhvillim të mesimit on-line, ka përdorur platforma elektronike si Google Meet, Google hangout, Zoom, etj.<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf; An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | GVJ konstatoi se në Rregulloren e Institucionit, njësisë bazë dhe atë të programit të studimit, përcaktohen qartë se format e kontrollit të dijeve janë komplekse dhe të larmishme, përkatësisht nëpërmjet:<br><br>• Aktivizimi në mësim<br>• Provim i ndërmjetëm.<br>• Detyrat e kursit ose ese.<br>• Provimi përfundimtar.<br><br>Studentët njihen qysh në fillim të semestrit me mënyrën e kontrollit të dijes dhe formën e organizimit të saj, në secilin modul. Sistemi i pikëzimit dhe i vlerësimit mbi bazën e pikëzimit është gjithashtu i standardizuar dhe i përcaktuar.<br><br>*Referenca: An._1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi_2022.pdf (Kreu IX – Vlerësimi i Dijeve); An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Kreu V-Kontrolli i Dijeve); An._3_4_ Rregullore e programit të* |

| | |
|---|---|
| | *studimit të MB (Kreu III- Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijeve; An. 3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Mënyra e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies bëhet nëpërmjet mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve si nga Njesia bazë, por edhe nëpërmjet metodologjive që implementon NJSBC, të cilat u shpjeguan në Standardin III.1, kriteri 5.<br><br>*Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf;*<br><br>*Rferenca: An. 3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf;An._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen..pdf; An._3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë..pdf An._3_32_Pyetësor për Pedagogun..pdf;*<br><br>*Refrenca: An. 3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë(NJSBC) viti akademik 2021-2022..pdf; An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë..pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe | KUQ trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores, metodat didatike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve.<br><br>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, KUQ ka në dispozicion 2 salla kompjuterike të pajisura me programe kompjuterike bashkëkohore, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike. Për programet e studimit me natyrë ekonomike, KUQ vendos në dispocion një laborator te Ekonomisës Aplikuar. Departamenti angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe |

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.<br><br>*Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf; An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE.pdf; An.1_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin-shkencore të stafit akademik të KUQ.pdf;*<br><br>*Referenca: 13.2.An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve..pdf; 17.1.Mobilitete per stafin, lista e pjesmarrsve.pdf*<br><br>*Refrenca: An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf; An.3_38_ Lista e softëare në Laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar.pdf* |
| **Konkluzione** | *Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktura në rregulloret përkatëse. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br><br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ | Dokumentacioni rregullator si edhe syllabuset e çdo lënde përcaktojnë qartë mënyrën e vlerësimit të studentit, e cila bazohet në vlerësimin e studentit në mënyrë të vazhduar. Vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra apo ese) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit). |

| | |
|---|---|
| moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Raporti ndërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohet në Regulloren e programit të studimit (Neni 13 & 14). Eshtë kompetencë e pedagogut që të informojë studentët, të cilët duhet të njohin jo vetëm mënyrën por edhe nivelin e përgjithshëm të pikëve paraprake, përpara se sa të përfundojë kursi përkatës. Vizita në institucion tregoi se nuk ekzistojnë paqartësi apo konflikte për këtë çështje.<br><br>*Referenca: An._3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Kreu V-Kontrolli i Dijeve); An._3_4_Rregullore e programit të studimit të MB (Kreu III- Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijeve, Neni 13 &14); An.3_7_Dosja e programit të studimit BACHMB..pdf.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | GVJ konstatoi mbështetjen e Institucionit për të inkorporuar në të ardhmen sisteme elektronike të testimit online. Gjatë periudhës së pandemisë Institucioni ka përdorur metoda të vlerësimit online për rezultatet e të nxënit. Këto metoda kanë përfshirë teste elektronike dhe quize online për përvetësimin e koncepteve kryesore të lëndëve si dhe portofolin digital që ka përfshirë bibliografi dhe Webliografi, ese apo ushtrime dhe detyra kursi, sipas programit lëndor.<br><br>*Referenca: An._1_23_Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Vlerësimi përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Siç është përmendur edhe në kriteret e mësipërme, vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra kursi apo ese) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit, saktësuar në syllabuset e çdo moduli). Ashtu siç e përcakton edhe ligji për arsimin e lartë modulet e programit të studimit |

| | |
|---|---|
| | janë të vlerësuara në kredite (ECTS), të cilat student i fiton pasi ka marrë një vlerësim pozitiv të vlerësimit përfundimtar.<br><br>*Refrenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Kreu III- Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijeve, Neni 13 &14); An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf.*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MB.* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i vazhduar dhe përmbyllës i çdo moduli njohurive shoqërohet me komente dhe argumentim për të ndihmuar studentin të kuptojë situatën e të nxënit dhe të përmirësohet. Studentët gjithashtu gëzojnë të drejtën e ankimimit, pasi njihen me rezultatet e provimeve. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme.<br><br>*Refrenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Kreu III- Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijeve, Neni 18); An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik përpiqen që të eleminojnë kopjimin dhe plagjiaturën.<br>• Së pari, personeli i ngarkuar me mbikqyrjen e provimit zbaton tërësisht rregulloren;<br>• Së dyti, komisioni i ngarkuar për vlerësimin jo vetëm zbaton rregulloren por ndërmerr edhe masa ndëshkimore në rast të shkeljes së saj. Kodi i Etikës, gjithashtu përcakton si elemente që përbëjnë shkelje disiplinore, plagjiaturën dhe kopjimin dhe masat që ndërmerren.<br><br>*Refrenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Neni 33); An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë (Neni 65)*<br><br>*Refrenca: An.1_5_Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Mbështetur në rregulloret përkatëse, përgjegjësi i departamentit kontrollon dhe miraton tezën, mbi bazën e të cilës kontrollohen dhe vlerësohen njohuritë dhe dijet e përfituara. Teza duhet të përfshijë të gjitha informacionet thelbësore të diskutuara në klasë gjatë zhvillimit të modulit.<br><br>Gjithashtu, veprimet dhe detyrimet pas përfundimit të provimit dhe kontrollit të tij, janë të përcaktuara në rregullore. Fleta e vlerësimit të provimit përmbylles dorëzohet në Sekretari e plotësuar nga pedagogu i lëndës jo më vonë se një javë ditë nga dita e kryerjes së provimit. GVJ gjykon që institucioni përdor të gjitha instrumentat efektivë që të garantojë rezultate të bazuara mbi meritokracinë.<br><br>*Refrenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Neni 27,29, 32, 33 &34); An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB Neni 15-18)* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br><br>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet, brenda dy ditëve (48 orë) nga shpallja e rezultatit të vlerësimit. Pedagou i lëndës apo komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni apo pedagogu i lëndës ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit.<br><br>*Refrenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Neni 34); An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB Neni 18)*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme. Vlerësimi përfundimtar i* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br><br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit Bachelor në "Administrim Biznesi" realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga: (1) lëndë bazë, (4) lëndë të formimit karakterizues (4) lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, lëndë plotësuese përfshihet vetëm praktika profesionale dhe në detyrimet përmbyllëse përfshihet provimi i përgjithshëm formimi. Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit, për të fituar aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit. *Megjithatë programi duhet të garantojë më tepër njohuri dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit dhe jo duke u fokusuar e fokusuar dhe profilizuar atë në drejtimin financiar.*<br><br>GVJ konsideron deri diku të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf; An._3_5_Plani strategjik i Programit të studimit MB..pdf*<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Plani Mësimor siguron informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar se program i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji (Informatikë, Sistemet e Inf. Kontabël), shkenca humane dhe shoqërore (E Drejtë Biznesi), si dhe komunikimit dhe ndërveprimit (Kuminikim Biznesi), por ka ende mundësi për përmirësime në zhvillimin e ketyre aftësive duke përfshirë lëndë si Sociologji, Sjellje Organizative, Etikë Biznesi etj. Veçanërisht me vlerë është organizimi dhe realizimi i praktikës profesionale në institucione, organizata dhe ndërmarrje publike dhe jo publike.<br><br>*Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MBi; An._3_9_ 2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MB.*<br><br>*Referenca: An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf;*<br><br>*Referenca: An._3_18_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MB..pdf; An._3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të pyetësorit të studentëve, diskutimeve me studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Tregues statistikorë të mbledhur nga institucioni, që reflektojnë ecurinë e studentëve, gjithashtu konsiderohen për të argumentuar efektivitetin e programit të studimit. Në përfundim të çdo moduli dhe semestri, pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës |

| | |
|---|---|
| | dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.<br><br>*Referenca: An.3_7_ Dosja e programit të studimit BACHMB.pdf; 14.Student te diplomuar BCH MB nota hyrje, dalje.pdf*<br><br>*Refrenca: An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 1; An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklarimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit. Një nga mënyrat e vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së përgatitjes të një detyre kursi, të vlerësuar me 20 % të vlerësimit prëfundimtar, në varësi nga specifikat e modulit si edhe vendimi i pedagogut përkatës. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për punën e temës së diplomës.<br><br>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë innovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Njësia, nga ana tjetër i krijon studentëve mundësi në përfshirjen e tyre në kërkime shkencore dhe aktivitete shkencore. Gjitahstu Institucioni është vazhdimisht aktiv në programin e këmbimeve akademike dhe kulturore, Erasmus.<br><br>*Referenca: An._3_26_Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi..pdf; An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë..pdf* |

| | |
|---|---|
| | *ReferencaL An._3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja..pdf; An._3_33_ Mobilitete me Universitetet e Jaen-it në Spanjë dhe Azerbajxhanit..pdf;*<br><br>*Referenca: An._3_30_ Konferenca IPE me pjesëmarrje Staf Akademik dhe student..pdf;*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | GVJ konstatoi se njësia bazë bën përpjekje intensive që të ofrojë të rejat më të përditësuara të shkencës dhe teknologjisë si nëpërmjet leksioneve të hapura ashtu edhe organizimit të seminareve. Në periudha të ndryshme vitit janë realizuar disa leksione të hapura me pjesëmarrje të ekspertëve të njohur të vendit. Në këto aktivitete gama e çështjeve të trajtuara paraqitet e larmishme.<br><br>*Referenca: An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf;*<br><br>*Referenca: 13.2.An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve..pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ konsideron deri diku të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës. Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklarimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Bazuar në rregulloren e Fakultetit (Kreu IX- Diplomimi), të Departamentit (Neni 48, Pika 2a) dhe të programit të studimit (Neni 21), përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Bachelor në "Menaxhim Biznesi". Për t'u diplomuar studenti duhet t'i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, i cili përfshin çështje kryesore të moduleve të realizuara gjatë zhvillimit të programit. Kjo me përjashtim të studentëve me mesatare jo më të ulët se 8 të cilët mund të zgjedhin punim diplome.<br><br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An._3_35_ Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)..pdf* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Personeli akademik orienton studentët duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione dhe udhëzime për materialet e nevojshme që duhet të konsultojnë në përgatitjen e provimit final. Në fillim të vitit të tretë studentëve i vendoset në dispozicion një program orientues për provimit final. Për studentët të cilët diplomohen me temë diplome, përveç fushave të ekspertizës së pedagogëve dhe temat orientuese nuk ka një udhëzues të posaçëm për pergatitjen e punimit të diplomës. *GVJ sugjeron që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përmirësojë udhëzuesin për realizimin e temës së diplomës.* Ky do të ishte nje dokument me vlerë për orientimin e studentëve, për vendosjen dhe respektimin e standardeve akademike të punimit të diplomës, për standardizimin e procesit të temës së diplomës për stafin dhe studentët në tërësi.<br><br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An._3_35_ Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)..pdf; An._3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese..pdf.* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e | Provimi përfundimtar i formimit teston njohuritë e fituara gjatë 3 viteve akademike nga studenti nga fushat e formimit te pergjithshem dhe të profilit. Në fillim të vitit të tretë studentëve i vendoset në dispozicion një program orientues për provimit |

| | |
|---|---|
| njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | final së bashku me literaturën e nevojshme, e cila depozitohet në departamento.<br><br>Teza e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar hartohet dhe menaxhohet nga komisioni i përcaktuar nga departamenti, të cilët përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe. GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.<br><br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf; An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf; An._3_4_Rregullore e programit të studimit të MB; An._3_35_ Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)..pdf; An._3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese..pdf.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Procedura për monitorimin, ndjekjen dhe udhëzimet e punimit të diplomës janë të shpjeguara në dokumentat: Rregullore e Fakultetit, Rregullore e Departamentit dhe Rregullore e Programit të studimit. GVJ konstatoi se përveç bazës rregullatore, nuk ka udhëzues të posaçëm për procedurën dhe pergatitjen e punimit të diplomës. <u>GVJ sugjeron</u> që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përmirësojë udhëzuesin për realizimin e temës së diplomës. Përmirësimi i këtij dokumenti do të ndihmojë për orientimin e studentëve, për vendosjen dhe respektimin e standardeve akademike të punimit të diplomës, për standardizimin e procesit të temës së diplomës për stafin dhe studentët në tërësi.<br><br>*Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf; An.3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf; An.3_4_1_Rregullore e diplomimit.pdf; An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB; An._3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese.pdf.*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Nga takimi i realizuar me studentët dhe stafin akademik rezulton se njësia bazë asiston dhe ndihmon studentët për kryerjen e analizave si në mjediset brenda IAL dhe jashtë saj.<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Rregullorja e Departamentit dhe ajo e brendshme e programit të studimit përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të studentit pas përfundimit të detyrimeve përmbyllëse. Si mbrojtja e diplomës dhe e provimit përfundimtar realizohet përpara një komisioni të përbërë nga 3-5 anëtarë, pedagogë të këtij program studimi, të cilët propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani. Gjithashtu, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës apo të hyjë në provimin përfundimtar pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Komisioni i ngritur për vlerësimin e studentëve në provën finale vlerëson me notë studentin sipas sistemit të vlerësimit të përcaktuar nga Institucioni.<br><br>*Referenca: An._3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Neni 51) (; An._3_4_1_Rregullore e diplomimit.pdf; An.3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Neni 21).*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti që ka plotësuar të gjitha detyrimet e planit mësimor dhe ka mbrojtur me sukses provën finale (provim formimi ose punim diplome) pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës. Modeli i diplomës është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, mund të vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.<br><br>*Referenca: An._3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf (Neni 53 & 55); An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB (Neni 21).* |
| | *Referenca: An._3_17_ Model i diplomës për programin e studimit MB..pdf; An._3_17_ 1_ Model suplementit për* |

| | |
|---|---|
| | *programin e studimit në MB..pdf;* Referenca: An._1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, rregjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.<br><br>Referenca: An._1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf<br><br>*Referenca: An._1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkvit.pdf*<br><br>*Referenca: An. _3_0_ Raporti i Vlerësimit të brëndshëm MB..pdf; Vizita në institucion* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.*<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përmirësojë udhëzuesin për procesin dhe përgatitjen e temës së diplomës.*<br><br>*Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.1<br><br>përsoneli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. përsoneli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</td><td>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, konstatohet se stafi akademik i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik dhe për fushën e ekspertizës. Në këtë program studimi janë të përfshirë gjate tre viteve akademike staf akademik si më poshtë vijon:<br><br>
<table>
<tr><td rowspan="2">Tituj/grada</td><td>2022-2023</td><td>2021-2022</td><td>2020-2021</td></tr>
<tr><td>PAE/PAK</td><td>PAE/ PAK</td><td>PAE/ PAK</td></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>4 / 0</td><td>4 / 0</td><td>3 / 1</td></tr>
<tr><td>Prof.As.Dr</td><td>2 / 2</td><td>3 / 2</td><td>3 / 4</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>7 / 1</td><td>6 / 1</td><td>4 / 3</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>6 / 0</td><td>7 / 0</td><td>7 / 0</td></tr>
<tr><td>Në total</td><td>19 / 3</td><td>20 / 3</td><td>17 / 8</td></tr>
</table>
<br>Drejtuesi i Departamentit mban graden shkencore "Doktor i Shkencave" dhe dekani i fakultetit mban titullin akademik "Profesor Doktor". Stafi administrativ është në nivel fakulteti, për shkak të numrit të vogël të studentëve.<br><br>Refrenca: An._3_12_ CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit MB..pdf<br><br>Referenca: 7.Stafi akademik me ngarkesen mesimore, për tre vitet e fundit.pdf</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. përsoneli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në</td><td>Duke iu referuar planit mësimor si dhe shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën orare si dhe numrin e lëndëve, në zbatim Udhezimin 29 dt 10.09.2018 te MAS. Referuar Dokumenti An._3_9_1 Plani mësimor i programit</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td><td>të studimit MB.pdf, rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë.<br><br>Referuar ngarkesës mësimore dhe stafit akademik që e mbulon, rezulton se ngarkesa qe mbulohet nga përsonel akademik efektiv ne tre vitet e fundit eshte nga 77% - 91%, e ngarkesës totale.<br><br><table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1665</td><td>1480</td><td>180</td><td>89 % / 11%</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>1665</td><td>1515</td><td>150</td><td>91% / 9 %</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>1665</td><td>1275</td><td>390</td><td>77% / 23%</td></tr></table><br>Referenca: An._3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MB.pdf<br><br>Referenca: 7.Stafi akademik me ngarkesen mesimore, per tre vitet e fundit.pdf</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e përsonelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë përiudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</td><td>GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV si dhe atë të siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se përgjithesisht nuk ka qarkullim stafi apo largime të stafit, te cilat konsiderohen te pakta, per shkak te daljes ne pension ose ne rastin e stafit te jashtem, mos sigurimi i lejes se mesimdhenies nga institucioni ku jane te punesuar. Nga konsultimi i dokumentacionit në zyrën e burimeve njerezore, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik.<br><br>Referenca: An._3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MB..pdf<br><br>Referenca: An._1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkvit.pdf<br><br>Referenca: An._1_7_2_Kontratë pune me stafin e KUQ.pdf</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur</td><td>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi praktika të rekrutimi të cilat, mbështeten në procedura rekrutimi dhe vlerësimi, me kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e përsonelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e përsonelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Kriteret si dhe nevojat propozohen nga Departamenti dhe njesia kryesore. Zyra e burimeve njerezore shpall njoftimin per vendet e lira dhe kriteret si dhe grumbullon dokumentacionin e aplikimit. Kriteret publikohen në ëebin e institucionit, KUQ vihet re se janë publikuar njoftime rekrutimi, kriteret si dhe data dhe ora e intervistës Në vijim rezulton se ngrihet një komision ku në përbërje të tij janë, rektori, dekani, administratori, përgjegjës të departamneteve dhe drejtuesi i zyrës së burimeve njerezore. Vlerësimi bëhet mbi procedura të ndara në dy faza, vlerësimi i dosjes dhe intervista. Komisioni miratohet nga rektori. Referuar praktikës së vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se komisioni ad-hoc i përcjell rektorit vendimin dhe ky i fundit ia percjellë atë admnistratorit te KUQ i cili ne vijim lidh kontratën me fituesit.<br><br>*Referenca: An._1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi_2022.pdf*<br>*Referenca:An._1_6_1_Proçedurat e emërimit të stafit akademik në KUQ.pdf*<br>*Referenca:An._1_6_Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkvit.pdf*<br>*An._1_7_3_Formulari i Aplikimit për staf akademik.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e përsonelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Referuar planit mësimor, ky program nuk ka një natyrë specifike teknike, të mbështetur në orë laboratori, por pavarësisht natyrës së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, nga vizita në institucion dhe nga konsultimi i RVB, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik si dhe staf akdemik për realizimin e orëve laboratorike të programeve të studimit si në orët e lëndës së informatikës, apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës. Ky staf është në nivel institucioni. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e përsonelit të angazhuar në programin e | Referuar dosjes së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi si dhe DVV, GVJ pati në dispozicion informacion për stafin akademik efektiv dhe joefektiv, ngarkesa e tyre sipas semestrave, lëndët që mbulojnë, Cv-të e tyre si dhe në zyrën e burimeve njerëzore u konsultuan informacion dhe i dosjeve të tyre, kualifikimet akademike, kontratat, Cv-te, Librezat e punës |

| | |
|---|---|
| studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave përsonale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e përsonelit akademik të përfshirë në program dhe të përsonit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të përsonelit ndihmës dhe administrativ. | etj. Për sa më sipër GVJ është e mendimit që informacioni i kërkuar në këtë kriter është i plotë.<br><br>*Referenca:An._3_12_ CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit MB..pdf*<br><br>*Referenca: An.1_6_2_Formati i dosjes personale të stafit.pdf*<br><br>*Referenca:An._2_8_Lista e dokumentave në dosjen e personelit.pdf* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion përsonelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Referuar numrit të vogël të studentëve si dhe marrëveshjeve që Kolegji disponon me kompani dhe institucione, GVJ është e mendimit se ky kolegj, nëpërmjet stafit të vet akademik dhe jo akademik, si dhe mentorëve në biznes, ka kapacitetet për udhëheqjen e studentëve në praktikë si dhe në punimin e diplomës. Për udhëheqjet e praktikës caktohet një pedagog mbikqyrës si dhe nje punonjës i kompanisë si mentor në biznes për praktikantin.<br><br>GVj vë re nga dokumenetacioni si dhe nga vizita në institucion se Kolegji, disponon 60 marrëveshje, kryesisht me biznese në fushën e hoteleri-turizmit, konsulencës në biznes, universitete etj. Institucioni rezulton se bën analiza për përfitimet e programit dhe të studentëve nga këto marrëeshje si ne dokumentin cituar me poshte.<br><br>*Referenca:An._3_15_ Model i dosjes së praktikës profesionale..pdf*<br><br>*Referenca:An._1_8_Marrrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit, brenda dhe jashtë vendi.pdf*<br><br>*Referenca: An.3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MB..pdf* |
| **Kriter 8.** përsoneli mbikqyrës në | GVJ konstaton se, marrëveshjet mes Kolegjit Universitar Qiriazi dhe institucioneve/kompanive kanë të përcaktuar të drejtat dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | detyrimet e palëve më potenciale për mbikëqyrjen e studentëve në praktika mësimore. Institucionet marrin përsipër të vendosin në dispocion mjediset e tyre si dhe mentorë për udhëheqjen/mentorimin e studentëve të programit të studimit Menaxhim Biznesi Biznesi. KUQ ndjek me stafin akademik ecurinë e studentëve në praktika duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me mentorët në biznese si dhe me studentët.<br><br>*Referenca:An._1_8_Marrrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit, brenda dhe jashtë vendi.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_39_ Model i realizuar për praktikën profesionale në MB..pdf* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe në vizitën në Kolegjin Universitar Qiriazi, vlerëson se përsoneli akademik që mbulon programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi, përmbush standardet sasiore dhe cilësore. Kolegji, dëshmon se ka numrin e duhur dhe me kualifikimin e duhur e të posaçëm të stafit akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni, ndjek praktika rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në rregulloren e institucionit dhe i bën ato transparente.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, | GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e KUQ, konstaton se mjediset janë mjedise të përshatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. KUQ rezulton se e zhvillon veprimtarinë e vet në një godine ekzistuese prej 1922, nga RVB rezulton se normativat e siperfaqes jane 7.8 $m^2$/student dhe 9.6$m^2$/staf. Godina është e strukturuar në salla leksionesh, |

| | |
|---|---|
| grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | seminaresh, zyra, laboratore, mjedise shlodhëse etj. Godina rezulton të këtë 3 salla leksionesh dhe 7 seminaresh, 1 sallë konference si dhe 2 laboratore si ambjente për biblioteken, sekretarinë, si dhe ambjente shlodhse për studentët dhe stafin.<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Referuar vizitës në institucion, konstatohen se klasat dhe laboratorët janë me kapacitete të mjaftueshme, përgjithësisht rezultonin të pajisur me videoprojektorë, ëhite board, PC dhe si rrjet interneti, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Gjatë vizitës në institucion, ne mjediset e KUQ, rezulton se sallat e leksioneve dhe seminareve, si dhe laboratorët, kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softet që i shërbejnë plotesimit të objektivave të programit, për realizimin e detyrave, prezantimeve audiovizive apo për përpunimet kompjuterike, në përputhje me natyrën e lëndëve të programit të studimit bachelor në Menaxhim Biznesi. Institucioni ka investuar ne ngritjen e laboratorit te Ekonomisë së Aplikuar.<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_38_ Lista e softëare në Laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar..pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale | Referuar evidencës infrastrukturore, rezultojnë 2 laboratorë disponibël. Për programet e studimit me natyrë ekonomike, KUQ vendos në natyrën dispocion një laborator te Ekonomisës Aplikuar. Gjatë vizitës në institucion konstatohen se laboratorët kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softe që përputhen me natyren e lëndëve |

| | |
|---|---|
| sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | specifike të programit të studimit bachelor në Menaxhim Biznesi, që i shërbejnë jo vetëm lëndës së informatikës, por edhe lëndëve të tjera si kontabilitetit etj.<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se KUQ vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, si dhe për formimin praktik të studentëve të këtij program, këto mjedise garantojnë kapacitetet e duhura fizike, laboratorike dhe me pajisjet e duhura për procese mësimdhënëse cilësore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe komunikoi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion nga ku rezulton se në dispozicion të studentëve është vendosur literature bazë dhe ndihmëse në shërbim të njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe angleze. Burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në data bazë në CD dhe DVD qe institucioni ka mundësuar. Pavaresisht sa më sipër GVJ nuk konstatoi nga RVB, nga takimet në institucion dhe as nga vizita ne bibliotekë, mundësi të bibliotekës elektronike apo të rregjistrimit të institucionit në biblioteka elektronike, të aksesuesheme nga stafi akademik dhe studentët.<br><br>*GVJ sugjeron që kjo literaturë të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive si dhe te shtohet fondi i librave hard copy.*<br><br>*GVJ rekomandon, institucionit që të krijojë mundesinë e bibliotekës elektronike online nëpërmjet rregjistrimit* |

| | |
|---|---|
| | *institucional në biblioteka elektronike, në të cilat stafi dhe studentët mund të sigurojnë literaturën bashkohore duke pasur parasysh edhe kontekstin tejet dinamik të studimeve në fushën e adminstrim biznesit.*<br><br>Kjo literaturë do të mbështë edhe rishikimin e Syllabuseve me literaturë primare dhe ndihmëse më të azhornuar dhe të mundshme për tu siguruar, duke informuar dhe orientuar studentët drejt trendeve të informacionit në fushën e ekenomisë, biznesit, administrimit publik etj.<br><br>*Referenca:An. 2_15_Lista e librave të reja sipas programve BCH në FE.pdf*<br><br>*Referenca:An.3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2..pdf*<br><br>*Referenca:An._1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Referuar dosjes së vetëvlerësimit rezulton se literatura në programet e lëndëve është kryesisht në gjuhën shqipe, libra universitarë në përputhje me programin. Njësia pergjegjëse ka raportuar dhe GVJ konsultoi dokumentacion të azhornimit të literaturës si dhe fond të akorduar për bibliotekën së bashku me listën e propozuar për azhornim që demosntrojnë se biblioteka pasurohet në vijueshmëri. GVJ e konsideron të paktet në numër, me botime kryesisht vendase dhe vite kryesisht të hershme propozimet e bëra për pasurim të bibliotekës fizike. Këto jane praktika të vlerësueshme por institucioni duhet të intesifikojë përpjekjet efektive, që keto burime të përdoren për alternativa më efektive të pasurimit të bibliotekës sic eshte regjistrimi në biblioteka digjitale.<br><br>*GVJ sugjeron që departamenti të azhornojë literaturën në syllabuse sipas kërkesave të VKM 41 të ndryshuar e të vijojë me kërkesat për azhornimin edhe të bibliotekës me tituj të viteve fundit.* Mbështetje për pasurimin e bibliotekës dhe mundësive për literaturë do të ishte edhe regjistrimi në biblioteka elektronike për të shfrytëzuar fondin e publikimeve |

| | |
|---|---|
| | kontemporane ne fushen e ekeonomise, manaxhimit, administrimit public etj, nga stafi dhe studentët.<br><br>*Referenca:An._3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._2_15_Lista e librave të reja sipas programve BCH në FE.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2..pdf*<br><br>*Referenca:An._1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | KUQ vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo bibliotekë është në shërbim për studentët e të gjitha njësive kryesore qe KUQ ka. Referuar Evidencave për infrastrukturën e KUQ, biblioteka është e pajisur me softe dhe me 4 PC dhe 15 poste shfrytëzimi.<br><br>Biblioteka ka një orar të përshtatshëm që siguron shfrytëzim të mirë nga studentët e programit nga e hëna në të shtunë, 08.00-17.00. Nga pikëpamja e kapaciteteve, GVJ është e mendimit se biblioteka ka kapacitete te pamjaftueshme infratsrukturale duke qenë se është bibliotekë në nivel institucioni dhe shfrytëzohet nga studentët e të të gjithë programeve të studimit.<br><br>*GVJ sugjeron, që institucioni duhet të zgjerojë kapacitetet infrastrukturale të bibliotekës me infrastrukturë fizike (poste fizike) si dhe me infrastrukturë digjitale, kompjutera, softe, data baza elektronike të aksesueshme nga studentët dhe stafi.*<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e | Duke iu referuar fondit të librit si dhe kapacitetit të bibliotekës rezulton se ajo është e pajisur me fond fizik librash në mbështetje të programit të studimit bachelor në MB, si literaturë bazë dhe ndihmëse dhe revista shkencore në përiodikë të fushave të ndryshme.<br><br>Në këtë fond të literaturës, janë librat bazë për lëndët e PS bachelor në Menaxhim Biznesi, si dhe literatura ndihmëse, shqip ose anglisht, sipas programit të lëndëve. Pavarësisht |

| | |
|---|---|
| përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | kësaj është e nevojshme azhornimi i bibliotekës me literaturë fizike të përditësuar si më sipër rekomanduar, me literaturë fizike dhe elektronike më të shumtë në numër si dhe të azhurnuar.<br><br>Për sa më sipër, <u>*GVJ sugjeron*</u> *që institucioni të mundësojë regjistrimin në biblioteka elektronike si U-Library, Jstor apo të tjera, si mundësi për stafin akademik dhe studentët, për të pasur në dispozicion më shumë tituj e për më tepër titujt të viteve të fundit, si mundësi për hulumtimet e materialeve për lëndët si dhe për zhvillimin e temës së diplomës.*<br><br>*Referenca:An._3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._2_15_Lista e librave të reja sipas programve BCH në FE.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka ofron kushte për shfrytëzim dhe akses të barabartë të fondit fizik dhe pa pagesë për studentët e kësaj njësie kryesore. Nga vizita në institucion rezulton se mjediset e bibliotekës janë në dispozicion të studentëve jo vetëm për shfrytëzimin e fondit të librit, por edhe si sallë studimi gjatë semestrit apo sezoneve të provimeve. Rezulton se burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në data bazën në CD dhe DVD që institucioni ka mundësuar. Pavaresisht sa më sipër GVJ nuk konstatoi biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi akademik dhe studentët.<br><br><u>*GVJ rekomandon*</u> *që institucioni të krijojë mundësinë e bibliotekës elektronike on-line nëpërmjet rregjistrimit institucional në biblioteka elektronike.*<br><br>*Referenca: An._3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB.pdf*<br><br>*Referenca:An._2_15_Lista e librave të reja sipas programve BCH në FE.pdf* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë | Referuar evidencës infrastrukturore të bibliotekës si dhe vizitës në institucion salla e bibliotekës është e pajisur me 4 PC te lidhur me internet si dhe disa pajisje të tjera si skaner e fotokopje. Studentët mund të përdorin dhe katalogun elektronik te bibliotekës. <u>*GVJ sugjeron*</u> *digjitalizimin e salls së biblioteks, me shtimin e kompjuterave dhe te softeve ne to për* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | *përdorim të data bazës si dhe aksesimin në secilin prej tyre të bibliotekave eketronike ku institucioni duhet të sigurojë akses.*<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka funksionon në orare zyrtare 08-17.00, nga e hëna në të shtunë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik. Mesimi në programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi Biznesi, zhvillohet nga e hëna në të premte, ndërkohë që orari i biblotekës është më i shtrirë në kohë dhe krijon mundësi shfrytëzimi të mirë nga studentët e këtij programi. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga përsoneli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për përformancën e përsonelit akademik. | GVJ konstatoi në dosjen e vetëvleresimit të bachelor në Menaxhim Biznesi Biznesi se funksionimi i bibliotekës, pasurimi i saj dhe cilësia e fondit të librit është pjesë e analizës vjetore të institucionit, I planifikimit buxhetor qe bëhët, e propozimeve qëvijnënga njësia kryesore për pasurim tëbibliotekës, sic demonstrohet edhe nga evidencat mëposhtë.<br><br>Pavarësisht për sa më sipër, *GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik të librit në gjuhën shqipe dhe përditësimin e saj, në përputhje me programin e studimit dhe sugjeron që kërkesat për libra të bëhen përiodikisht nga stafi i departamentit si dhe të kenë një fond të parashikuar në buxhet për pasurimin e përvitshëm të bibliotekës.*<br><br>*Referenca:An._3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë..pdf*<br><br>*Referenca:An._1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se kushtet fizike të bibliotekës se KUQ, janë të përshtatshme për t'ju sherbyer studentëve dhe stafit akademik.* |

| | |
|---|---|
| | *GVJ sugjeron shtimin me tituj të fundit te fondit fizik dhe rregjistrim në biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi dhe studentët.*<br><br>*GVJ sugjeron pasurimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet e viteve të fundit të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi si dhe rritjen e kapciteteve infrastrukturale te bibliotekës me poste fizike, Pc dhe biblioteka elektronike të aksesueshme në to.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të Menaxhim Biznesi Biznesiit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të Menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Referuar RVB, vizitës në sekretarinë mesimore si dhe Evidencave të DVV, GVJ konstaton se KUQ disponon një Sistem të Menaxhim të Informacionit, SMI, që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritë si dhe zyrën e IT. Përveç dokumentacionit letër të disponueshëm ne zyrat e KUQ, ky sistem elektronik i Menaxhim te informacionit, krijon mundësi aksesi në informacionin e vlerësimit të studentëve, akses për studentet, stafin akademik dhe zyrat mbështetëse te institucionit.<br><br>Nga vizita në institucion si dhe nga RVB, konstatohet se institucioni është duke implementuar një sistem të manaxhimit të të mësuarit (Learning Management system LMS), duke e orientuar procesin e manaxhimit të informacionit jo vetëm administrativ por edhe atij të të nxënit drejt drejt përdorimit të standardeve digjitale profesionale.<br><br>*Referenca:An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._1_28_Faqja zyrtare e internetit (ëëë.qiriazi.edu.al.) të KUQ.pdf* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i Menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e përsonelit akademik, përsonelit ndihmësakademik, përsonelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | GVJ konstaton se përveç sistemit elektronik SMI, për stafin dhe studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore. Për studentët informacioni përveçse në sistem, mund te sigurohet edhe ne ëebin e institucionit si dhe rezulton i ruajtuar edhe nëpërmjet regjistrit themeltar, regjistrit të përparimit akademik të studentëve, si dhe regjistrit të lëshimit të diplomave. Këto regjistra u konsultuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion dhe rezultuan me informacion e plotë të kërkuar.<br><br>*Referenca:An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_28_Faqja zyrtare e internetit (www.qiriazi.edu.al.) të KUQ.pdf* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i Menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë përsonelin dhe studentët e programit të studimit. | Referuar përdorimit të sistemit, GVJ konstatoi se sistemi SMI, ka hapësirën virtuale të çdo pedagogu/lënde, për komunikim interaktiv me studentët. Përveç sistemit, institucioni për komunikim interaktiv dhe zhvillim të mesimit on-line, ka përdorur platforma elektronike si Google Meet, Google hangout, Zoom, etj.<br><br>*Referenca:An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i Menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet përsonelit akademik dhe studentëve. | GVJ nga vizita në sekretarinë e KUQ, dhe konsultimit të dokumentacionit konstaton se përveç formës shkresore të ruajtjes së informacionit në regjistra, institucioni ka sistemin elektronik SMI, i cili me kapacitetin që ka, mendojmë se ndihmon të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në manaxhimin e informacionit për sekretaritë etj. Me implemetimin e LMS sic u trajtua më sipër dhe që është në proces, GVJ është e mendimit se ky shkëmbim informacioni do të jetë edhe më i plotë e më profesional. |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf*<br>*Referenca:An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i Menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpëmjet kredencialeve të tyre përsonale, nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik informon studentët për rezultatet, nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to. Sistemi elektronik i informacionit të Menaxhimit, rezulton një sistem që suporton komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, duke e bërë komunikimin mes tyre më efektiv. Pavaresisht potencialit që sistemi ka, *GVJ sugjeron që institucioni të sensibilizojë studentët kryesisht, por edhe stafin akademik për përdorimin e sistemit dhe minimizimin e formave tradicionale të komunikimit me studentët, të notave, ankimimeve apo informacioneve të tjera, dhe përforcimin rutinor të përdorimit të sistemit prej tyre.*<br>*Referenca:An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, përsonelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | KUQ ka një faqe interneti me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitë kryesore, si dhe informacion që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme të njësive të tjera. Faqja zyrtare është në gjuhën shqipe. Në faqen zyrtare ofrohet mundësi aksesi për përdoruesit e brendshëm me anë të kredencialeve përsonale.<br>*GVJ sugjeron axhurnimin e faqes zyrtare të KUQ edhe në gjuhën angleze.*<br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al* |
| **Konkluzione** | *Sistemi i Manaxhimit të informacionit në Kolegjin Universitar Qirjazi, rezulton një sistem informacioni i integruar dhe efektiv për të lehtësuar dhe përshpejtuar shpërndarjen e informacionit mes stafit akademik dhe administraiv dhe studentëve. GVJ sugjeron axhurnimin e faqes zyrtare të KUQ edhe në gjuhën angleze.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| **Standardi IV.5** **Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, KUQ, harton një raport vjetor i cili depozitohet në mënyrë të përvitshme në MAS, sic evidentohet edhe në shtojca. Referuar DVV, pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe plani buxhetor, i cili kalon për miratim në bordin e Administrimit. GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar një plan të detajuar buxhetor për institucionin, një plan buxhetor për Fakultetin e Ekonomisë si dhe një plan për financimin e programit të studimit, referuar dokumentacionit të konsultuar nga GVJ në dosjen e vetëvlerësimit dhe të referuar mëposhtë në evidencë.<br><br>*Referenca: An._1_14_1_Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_14_1_Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit.pdf*<br><br>*Referenca: An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_21_Shkresa nr.210, dt.28.12.2022 e KUQ për MAS, dërgim raporfti vjetor.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_21_ 2_Plani i financimit të programit të studimit MB.pdf* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës | Referuar RVB dhe DVV, rezulton se plani buxhetor për Fakultetin e Ekonomisë si dhe plani për financimin e programit të studimit, referuar dokumentacionit të konsultuar nga GVJ në dosjen e vetëvlerësimit dhe të referuar më poshtë në evidencë paraqet informacion për zërat që do të financohen dhe nga çfarë burimesh financohen, që janë kryesisht nga fonde te institucionit nga tarifat e studentëve dhe prej aktiviteve të biznesit të ortakut të vetëm, që është edhe administrator, sic rezulton nga RVB. Ne plan paraqiten fondet për financim të digjitalizimit, të fondeve për bibliotekën, për kërkimin shkencor etj. (evidencat cituar më poshtë)<br><br>*Nuk konstatohen fonde financimi nga donatorët apo projektet.* |

| | |
|---|---|
| e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Pavarësisht sa më sipër duke qenë se institucioni në programin e studimit për të cilin është ky process vlerësimi, bachelor në MB, ka një numër të vogël studentësh dhe të ardhuart që vijnë prej tarifave të studentëve të programit janë të vogla. Gjithashtu të ardhurat nga burime të tjera të diversifikuara, si shërbime ndaj të tretëve apo të ardhura nga projektet mungojnë.<br><br>*Referenca: An.1_14_1_Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit.pdf*<br>*Referenca: An.3_41_ Fondi i Digitalizimit.pdf*<br>*Referenca: An.1_16_1_Miratim i fondit, për punën shkencore viti akademik.pdf*<br>*Referenca:An._3_26_Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi..pdf*<br>*Referenca:An._3_40_ Plan buxhet i detajuar për Fakultetin e Ekonomisë..pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim përiodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | GVJ konstaton nga RVB se auditimi është një proces vullnetar me kërkesë të ortakut të vetëm të shoqërisë bëhet i përvitshëm, institucioni raporton gjithashtu si kërkesë ligjore, cdo fund viti në MAS dhe raportet finaciare cdo vit dorëzohen pranë degës rajonale të Tatim Taksave.<br><br>*Referenca:An._1_14_1_Plani buxhetor (018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit.pdf*<br>*Referenca:An._1_21_Shkresa nr.210, dt.28.12.2022 e KUQ për MAS, dërgim raporfti vjetor.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e | Referuar RVB si dhe DVV, rezulton se KUQ i siguron të ardhurat nga tarifat e studentëve dhe nga të ardhurat e rrjetit të biznesve që ortaku i vetëm i shoqërise ka.<br>Për qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe planin e tij është hartuar një plan strategjik i cili është miratuar nga Bordi i Administrimit. Pavarësisht sa më sipër duke qenë se institucioni në programin e studimit për të cilin është ky proces vlerësimi, bachelor në MB, ka një numër të vogël studentësh dhe të ardhurat që vijnë prej tarifave të studentëve të programit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | janë të vogla. Gjithashtu të ardhurat nga burime të tjera të diversifikuara, si shërbime ndaj të tretëve apo të ardhura nga projektet mungojnë.<br>Pavarësisht sa më sipër, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve, <u>*GVJ sugjeron*</u>*, se KUQ duhet të sigurojë forma alternativa të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se KUQ, harton dhe miraton plane financimi ne nivel institucioni, fakulteti dhe program. Pavarësisht sa më sipër, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve,* <u>*GVJ sugjeron*</u>*, se KUQ duhet të sigurojë forma alternativa të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin | GVJ konstaton se KUQ ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë të Bachelor në Menaxhim Biznesi, nga hyrja deri në diplomim të studentëve në PS Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto procedura janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit, të fakultetit dhe të departamnetit KUQ dhe publikohen edhe në ëebin e institucionit. |

| | |
|---|---|
| në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | *Referenca: An._2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf*<br><br>*Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi_2022.pdf*<br><br>*Referenca: https://qiriazi.edu.al/wp-content/uploads/2023/05/Botime-3-vite-web.pdf* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se dokumentet strategjike të KUQ, si rregullore e institucionit, rregullore e fakultetit, rregullore e programit, fokusohen në trajtimin e barabartë dhe sipas meritokracisë, referuar procedurave të përzgjedhjes së studentëve si dhe atyre të vlerësimit të avancimit akademik të tyre.<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Referuar takimeve me drejtues së njësisë kryesore dhe asaj bazë, ëebit zyrtar si dhe DVV, rezulton se institucioni publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithëshme që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto kritere miratohen nga senati akademik dhe publikohen në faqen zyrtare. Referuar kritereve për vitin akademik 24-25, aksesuar nga GVJ në faqen zyrtare të internetit, rezulton se kriteret janë vetëm kritere të përgjithshme dhe konkretisht nota mesatare e shkollës së mesme, sipas bazës ligjore. Kriteri për tu pranuar, është mesatarja e shkollës së mesme.<br><br>*Referenca: Kriteret e Pranimit 24-25 - https://qiriazi.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/*<br><br>*Referenca: An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë KUQsit të studimit, të transferimit, | GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit së studentëve janë të publikuara në ëebin zyrtar të KUQ dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Informacioni në ëeb ofrohet edhe për mundësitë e përfitimit të bursës, |

| | |
|---|---|
| njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | transferimet, oraret mësimore si dhe për kalendarin e provimeve.<br><br>Informacioni në web për studentet është i plotë dhe jepet në gjuhen shqipe Më poshtë linket e konsultura nga GVJ për këtë kriter.<br><br>*Referenca:Kriteret e Pranimit 24-25 - https://qiriazi.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/transfero-studimet-ose-vazhdo-nje-program-te-dyte-studimi/*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/datat-e-provimeve-ne-sezonin-e-vjeshtes/* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ duke iu referuar DVV si dhe ëebit të instituconit, konstaton se Kolegji Universitar Qiriazi, realizon informimin e publikut për kërkesat e pranimit në Bachelor në Menaxhim Biznesi nëpërmjet ëebit të institucionit si dhe nëpërmjet aplikimit on-line sic mund të konstatohet nga ëebi zyrtar. Institucioni sensibilizon publikun edhe për mundësinë e përfitimit të bursës së ekselencës, talentit apo sociale.<br><br>*Referenca:An._1_25_ Kriteret e pranimit të studentëve.pdf*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS bachelor në Menaxhim Biznesi, të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i administrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kritereve për shtresat e margjinalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështetet në udhëzimet e MAS. Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.<br><br>*Referenca:An._1_17_ Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Unive.pdf*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/kuotat-e-pranimit/* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon | Referuar njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit, rezulton se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera si |

| | |
|---|---|
| përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | dhe kuotat për ta janë hartuar në përputhjes me udhëzimin e MAS nga departamenti, janë miratuar nga senati akademik dhe bordi i administrimit i KUQ, si dhe janë publikuar për informim të gjerë të palëve të interesuara. Fokusi i këtyre kritereve, vendoset tek mesatarja e shkollës mesme.<br><br>*Referenca:An._1_17_ Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Unive.pdf*<br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/kuotat-e-pranimit/* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Referuar faqes zyrtare të internetit të institucionit si dhe DVV, GVJ konstaton se institucioni ofron informacion të plotë për përfitimin e bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten si bursa talenti, bursa ekselence si dhe bursa sociale. Në DVV insitucioni vendos në dispozicion edhe vendime të BOA për bursat. Në këtë vendim GVJ konstaton se bursat e meritës janëpër studentët me mesatare mbi notën 8. GVJ gjatë takimit me studentët studentët demonstruan njohuri për sistemin e bursave dhe identifikuan studentë që kanë përfituar bursa.<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/apliko-per-burse/*<br>*Referenca:An._1_15_ Vendimi i Bordit Administrativ për tarifa dhe bursa_VF.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në ëeb e institucionit në gjuhën shqipe.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2** |
|---|

Adresa: "Rruga e Durrësit"
E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se KUQ ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e institucionit, të njësisë kryesore si dhe të programit bachelor në Menaxhim Biznesi. GVJ vlerëson se ky informim bëhet në forma alternative, nëpërmjet sekretarisë mësimore, pedagogëve, koordinatorit të programit si dhe nëpërmjet zyrës së këshillimit si dhe nëpërmjet ëebit të fakultetit.<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf*<br>*Referenca:An._1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf*<br>*Referenca:An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstatoi se KUQ në faqen zyrtare publikon kriteret për transferimet për informim të gjerë, gjithashtu nga takimi me studentët rezulton se informohen parimisht nëpërmjet akteve të cituara në kriterin më sipër dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit, sekretarisëmësimore etj.<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/transfero-studimet-ose-vazhdo-nje-program-te-dyte-studimi/* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Referuar DVV, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin e programit, GVJ konstaton nga takimet me stafin dhe studentët, se ata informohen nga pedagogët e çdo lënde në orën e parë të semestrit për syllabuset, detyrimet lëndore, kriteret e vlerësimit, etj, këto kritere janë pjesë të rregullores së institucionit dhe të rregullores së programit që gjithashtu rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të IAL.<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf*<br>*Referenca:An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._3_16_ Rregullore e praktikës profesionale..pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Për GVJ rezulton se informimi për punimin e diplomës si dhe për provimin e diplomës nëfillim tësemestrit tëdytë. Ky informim bëhet nga njësia bazë, duke informuar studentët për bazën e pyetjeve të provimit të përgjithshëm si dhe për temat e sugjeruara si dhe kapacitet udhëheqëse të stafit si dhe kriteret e punimit të një teme diplome. GVJ nuk konstatoi udhëzues teme diplome.<br><br>*<u>GVJ sugjeron</u> që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përgatisë një udhëzues të posacëm për realizimin e temës së diplomës.* Ky do të ishte nje dokument me vlerë për orientimin e studentëve, për vendosjen dhe respektimin e standardeve akademike të punimit të diplomës, për standardizimin e procesit të temës së diplomës për stafin dhe studentët në tërësi.<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_4_1_Rregullore e diplomimit..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_35_ Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)..pdf* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Rezulton nga DVV se institucioni organizon ditë informuese dhe orientuese për student të ardhshëm të programit në shkollat e mesme si dhe nëpërmjet Diteve te hapura nëinstitucion. Të interesuarit infomohen edhe me anë të mesazheve promocionale që jepen në mediat lokale si dhe nepërmjet shpërndarjes së posterave dhe rrjeteve sociale tëinstitucionit.<br><br>*Referenca:An._1_27_Rreth marketingut të Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf*<br><br>*Referenca:An._1_26_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar_Qiriazi.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për kriteret e vlerësimit, kuotat, transferimet, për* |

| | |
|---|---|
| | *detyrimet lëndore, për punimin e temës së diplomës si dhe informim për studentët e ardhshëm.*<br><br>*GVJ sugjeron që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përgatisë një udhëzues të posacëm për realizimin e temës së diplomës. Ky do të ishte nje dokument me vlerë për orientimin e studentëve, për vendosjen dhe respektimin e standardeve akademike të punimit të diplomes, për standardizimin e procesit të temës së diplomës për stafin dhe studentët në tërësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | GVJ konstatoi se institucioni informon studentët me informacion të plotë lidhur me programin. Ky informacion konsiston, në kohëzgjatjen e programit, strukturën e çdo semestri, formën e organizimit, detyrimet që studentët kanë etj. GVJ konstatoi se ky informim realizohet nga departamenti dhe stafi akadamik nepërmjet syllabuseve, strukturat e sekretarisë mësimore si dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës për orarin mesimor si dhe për kalendarin e provimeve etj. Studentët rezulton se informohen gjithashtu në distancë nëpërmjet faqes zyrtare, videove promovuese dhe broshurave që paraqesin informacion për programin e studimit bachelor ne Menaxhim Biznesi si dhe nëpërmjet SIM.<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/datat-e-provimeve-ne-sezonin-e-vjeshtes/*<br><br>*Referenca:An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2..pdf*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/kalendari-akademik-2023-2024/* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ konstaton se gjatë takimeve me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit dhe studentët e PS në Bachelor në Menaxhim Biznesi, se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti, informon në mënyrë specifike për studentët për lëndën, syllabusin, literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lënde, format dhe skemat e vlerësimit që janë të sanksionuara në rregullore dhe në syllabuse, etj.<br><br>*Referenca:An._3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MB-së pjesa 2..pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Nga takimi me përfaqësues të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës, rezulton se kjo zyrë zhvillon aktivitete për orientimin në tregun e punës, por këto aktivitete deri tani rezultojnë të pakta dhe sporadike. Studentët informohen edhe nëpërmjet fletëpalosjeve, informacionit të publikuar në web.<br>***GVJ rekomandon** që aktiviteti i zyrës së Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës duhet të jetë më i organizuar, më vizibël, më proaktiv, me frekuent, mbështetur në aktivitete të përshatura me nevojat e studentëve, sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.*<br><br>*Referenca:https://qiriazi.edu.al/ëork-and-travel-punesime-sezonale-per-studentet/*<br>*Referenca:An._2_16_Statistikë mbi diplomimin dhe punësimin në FE.pdf* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentët rezultojnë të informuar rreth procesit mësimor, lëndëve, programeve, formave të vlerësimit, infrastrukturës në shërbim të tyre etj. Rezultoi se institucioni realizon edhe ditë të hapura për studentët e rinj sipas një kalendari informues, jo vetëm për procesin mesimor por edhe për aktivitete të tjera dhe shërbimet që ofrojnë zyrat mbështetëse. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet | GVJ konstaton gjatë vizitës në institucion, se sistemi elektronik mundëson akses në informacion lidhur me procesin mësimor, syllabuset, leksionet e parashkruara apo prezantimet |

| | |
|---|---|
| përmes sistemit të Menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | në poëerpoint në hapësirën e pedagogut, detyrimet lëndore, oraret e mësimit dhe kalendarin e provimeve, vlerësimin e çdo lënde etj. Gjithashtu për studentet e ardhshëm apo për publikun e gjerë, një pjesë esenciale e këtij informacioni konstatohet se ofrohet edhe nepërmjet ëebit zyrtar në gjuhën shqipe.<br><br>*Referenca:An._1_23_Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se institucioni informon për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit nëpërmjet sekretarisë mësimore, stafit akademik si dhe faqes zyrtare të internetit në tre gjuhë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe me sekretarinë, konstaton se KUQ harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS Bachelor në Menaxhim Biznesi Biznesi. Referuar regjistrave themeltar, nga vizita në institucion rezulton se numri i studentëve për 3 vite akademike është: |

| Vitet | Rregjistrime | Transferime | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| 2020-2021 | 12 | 3 | 15 |
| 2021-2022 | 8 | 1 | 9 |
| 2022-2023 | 10 | 2 | 12 |

Sic shihet dhe nga tabela më sipër, numri i të rregjistruarve është relativisht i ulët në tre vitet e fundit. *<u>GVJ sugjeron që</u> institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për promovimin e*

| | |
|---|---|
| | *programit dhe sigurimin e mekanizmave për rritjen e numrit të studentëve të programit.*<br><br>*Referenca:An._1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf*<br>*Referenca:An._1_7_ Rregullore e mbrotjes së të dhënave personale të KUQ.pdf*<br>*Referenca:An._3_29_Tabelë përmbledhëse për programin për studentët në hyrje dhe në dalje në tre vitet e fundit..pdf*<br>*Referenca:14.1.Statistike e kërkuar nga ASCAL për programin BCHMB.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se KUQ mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në çdo lëndë, rregjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të çdo lënde në hard copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar ku çdo student rezulton i regjistruar dhe është pajisur me numer matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të rregjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, mandatë pagesë, etj.<br><br>*Referenca:An._1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf*<br>*Referenca:An._1_7_ Rregullore e mbrotjes së të dhënave personale të KUQ.pdf*<br>*Referenca:An._3_29_Tabelë përmbledhëse për programin për studentët në hyrje dhe në dalje në tre vitet e fundit..pdf* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga përsonat e autorizuar. | GVJ konstatoi se, të dhënat për studentët si regjistrimet, vlerësimet e çdo lënde, detyrimet akademike të studentëve, mbahen manualisht në sekretarinë e KUQ, si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit nga sekretaria, sipas procedurave që parashikohen në për këtë sistem dhe nëpërmjet të drejtave që kanë në aksesimin në sistem, strukturat përgjegjëse monitorojnë saktësinë e tyre dhe përputhshmerinë me rregjistrat manualë.<br><br>*Referenca:An._3_29_Tabelë përmbledhëse për programin për studentët në hyrje dhe në dalje në tre vitet e fundit..pdf* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin përiodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për Menaxhim Biznesi Biznesiin (sekretaritë mësimore, sistemin e Menaxhim Biznesi Biznesiit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se proceset mbikëqyrëse si dhe strukturat që kanë përgjegjësinë e kryerjes së proceseve mbikëqyrëse dhe të monitorimit janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit këto përgjegjesi ushtrohen nga strukturat drejtuese të institucionit si dhe nga NJSBC.<br><br>*Referenca:An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | KUQ disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje dhe në dalje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore. GVJ mbështëtur ne DVV, konstatoi se këto të dhëna bëhen pjesë e analizës së departamentit dhe raportit vjetor në nivel institucioni dhe shoqërohen me plan masash.<br><br>*Referenca:An._3_3_ Analizë vjetore e Departamentit të Menaxhimit..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_36_Raport mbi panairin e punës..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_23_Tabela mbi punësimin e të diplomuarve në programin BACHMB..pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi Biznesi, nga pranimi deri në diplomim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5** |
|---|

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, dhe në Statutin e KUQ. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në DVV se studentët janë të përfaqësuar ne njësinë e Sigurimit të cilësisë, Senatin akademik, në grupin e vlerësimit të brëndshëm institucional dhe GVB programore si dhe në Këshillin e Etikës. Gjithashtu kolegji mbështet këshillat studentore për të cilët rezulton që institucioni i mbështet me financim si dhe me infrastrukturë që të funksionojnë. Rezulton nga evidencat se ta marrin pjesëedhe nëmbledhjet e njësisëbazë.<br><br>*Referenca:An._3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Referuar dosjes së vetëvlerësimit, studentët rezultojnë pjesë e komisioneve të vetëvlerësimit të institucional dhe programor. Gjithashtu ata marrin pjesëne mbledhjet e njesisë bazë. Pjesëmarrja e tyre në këto procese të vlerësimit të brendshëm, krijon mundësinë që studentët të përcjellin përceptimin e tyre, sugjerimet e tyre për proceset mësimore, funksionimin e strukturave të institucionit etj. Studentët përcjellin mendimet e tyre edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në anketimin që bëhet çdo semestër për vlerësimin e procesit akademik dhe te infrastruktures se institucionit.<br><br>*Referenca:An._3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf*<br><br>*Referenca:An._2_13_ Pyetsorët për studentët në FE.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_20_2 Pyetësor për gjurmimin e studentëve KUQ..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të PS në Bachelor në Menaxhim Biznesi, është indirekt nëpërmjet feedbackut që njësia bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB. GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor, megjithatë *<u>GVJ rekomandon</u> që krahas zhvillimit të pyetësorit të përdoren edhe instrumente të tjerë në funksion të përmirësimit të programit, nepërmjet përfshirjes së perceptimit të studentëve.* Psh, zhvillimi i fokus grupeve, etj. Këto mund të shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe përmirësimin e tij në vazhdimësi, nëse pyetësorët nuk e ofrojnë këtë informacion.<br><br>*Referenca:An._3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.pdf*<br><br>*Referenca:An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit brenda 48 orësh, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu i lëndës vendos notën përfundmtare. Nëse studenti serish e ankimon këtë rezultat, i drejtohet me shkrim përgjegjesit te departamentit, për te ngritur një komision të ri për rishikimin e rezultatit. Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin përceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se studentët rezultojnë të përfaqësuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse, por* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *referuar takimeve me studentët, GVJ sugjeron qe institucioni të nxisë një angazhim më proaktiv të tyre.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, Menaxhim Biznesi Biznesiin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | GVJ konstaton se KUQ ka procedura dhe njësi të posacme në strukturën organizative, sic janë, Koordinatori i programit, Departamenti, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës, të cilët zhvillojnë procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e tij dhe në legjislacionin përkatës.<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij..pdf*<br><br>*Referenca:An._1_9_Rregullore e Zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | GVJ konstaton se KUQ ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, që kanë përbërje të tyre, struktura në nivel institucioni sic është, Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Këshillim Karrierës, sekretaria mesimore si dhe kordinatori i programit<br><br>*Referenca:An._3_4_ Rregullore e programit të studimit të MB..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij..pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._1_9_Rregullore e Zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat ZMJKK duhet të kryej. GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturantët të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë.<br><br>Pavarësisht për sa më sipër, *GVJ sugjeron se ZMJKK, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me internshipe pranë kompanive dhe për punësimin e tyre të ardhshëm, këto aktivitete sugjerohen të jenë më të organizuara, të formalizuara dhe më të gjurmueshme.*<br><br>*Referenca:An._1_9_Rregullore e Zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë.pdf*<br><br>*Referenca:An._3_36_Raport mbi panairin e punës.pdf*<br><br>*Referenca:13.1.Veprmtari me studentet. Zyra e Karrieres.pdf*<br><br>*Referenca:13.2.An._3_25_Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_23_Tabela mbi punësimin e të diplomuarve në programin BACHMB..pdf* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstatoi se ZMJKK ndjek studentët pas diplomimit, u konstatuan pyetësor gjurmimi si dhe një raport të këtij procesi gjurmimi ku analizohen te dhënat e siguruara gjatë procesit tëgjurmimit. Gjithësesi, GVJ nuk konstatoi të dhëna për krijimin e rrjetit të Alumni të institucionit dhe as aktivitete të përfshirjes së Alumnit të institucionit, në proceset e institucionit.<br><br>*GVJ sugjeron krijimin e rrjetit Alumni si dhe aktivizimin e tyre në tryeza këshilluese edhe vendimmarrëse për përmirësimin e programit të studimit MB. GVJ konstatoi se institucioni mban statistika të punësimit të studentëve që kanë mbaruar Bachelor në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Referenca:An._3_24_Raporti për gjurmimin e studentëve..pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca:An._3_20_2 Pyetësor për gjurmimin e studentëve KUQ..pdf*<br><br>*Referenca:An._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se institucioni duhet të rrisë efektivitetin e zyrës së Marrëdhënieve me jashtë dhe Këshillimit të Karrierës, për të siguruar një lidhje më të mirë me tregun e punës dhe një orientim më të mirë të studentëve si dhe krijimin e rrjetit Alumni.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me stafin akademik dhe atë drejtues të programit, konstaton se institucioni në kushtet e mësimit në distance për shkak të pandemisë, ka hartuar dhe publikuar një udhëzues në nivel institucional për përdorimin e platformave të mësimdhënies.<br><br>*Referenca: An._1_23_Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.pdf* |
| | *Referenca: An._1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies.pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf*<br>*Referenca: An._1_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin-shkencore të stafit akademik të KUQ.pdf* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të përsonelit akademik dhe ndihmësakademik. | Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, GVJ konstaton se strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin si dhe njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrolle të zhvillimit të mësimit, aplikimin e pyetsorëve si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të përformancës së stafit akademik në disa fusha, etj.<br><br>*Referenca: An._3_32_Pyetësor për Pedagogun..pdf*<br>*Referenca: An._3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf*<br>*Referenca: An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin përiodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj. GVJ konstaton se institucioni aplikon edhe nje pyetësor për studentët para diplomimit për të siguruar informacion për cilësine e programit tëstudimit. Rezulton se studentët kanë përfaqësim në NJSBC dhe ata sigurojnë informacion për identifikimin e problematikave që kanë nevojë për përmirësim apo të identifikimit të praktikave tëmira të cilat mund të shpërndahen.<br><br>*Referenca: An._3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf*<br>*Referenca: An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf*<br>*Referenca: An._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen.pdf* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin | GVJ konstatoi se zyra e NJSBC, harton një raport vjetor me rezultatet e pyetësorëve të përdorur, atë të studentëve, të studentëve para diplomimit si dhe të pedagogëve. Në RVB |

| | |
|---|---|
| e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | konstatohet se ky raport shqyrtohet nga strukturat vendimmarrëse në nivel institucioni dhe njësie kryesore dhe nëpërmjet tyre edhe stafin akademik. Pjesë të këtij raporti përfshihen edhe në raportin vjetor të institucionit. Por GVJ konstaton se raporti është një raport shumë sintetik, nuk identifikon në mënyrë specifike analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Ky raport nuk identifikon gjetje kryesore nga mekanizma të tillë sic janë pyetësorët, por më shumë mbështet në të dhëna sekondare si statistikat e studentëve, stafit, kërkimit shkencor, programeve. GVJ konstaton se ky raport rekomnadimet i ka të përgjithshme dhe nuk iu referohet gjetjeve të pyetësorëve por të dhënave sekondare. Pavarësisht sa më sipër, nga DVV si dhe nga vizita në institucion, GVJ nuk konstatoi praktika të shpërndarjes së vlerësimit të pyetësorëve tek stafi.<br>*GVJ sugjeron që institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyërë konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjitshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara.*<br><br>*Referenca: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf*<br>*Referenca: An._3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë(NJSBC) viti akademik 2021-2022..pdf*<br>*Referenca: An._3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf*<br>*Referenca: An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf*<br>*Referenca: An._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen..pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit përsonelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, GVJ sugjeron që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikat e mira, për promovimin e kulturës së cilësisë, sikur se edhe diskutimin në rang departamenti të gjetjeve kryesore në terma të përgjithshëm si dhe ndarjen me stafin në mënyrë konfidenciale të rezultateve të vlerësimit, të secilit pedagog. |
| **Konkluzione** | *GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se Kolegji Universitar Qiriazi, ka një politikë për garantimin dhe* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies. GVj konstaton se raporti është një raport shumë sintetik, nuk identifikon në mënyrë specifike analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Ky raport nuk identifikon gjetje kryesore nga mekanizma të tillë sic janë pyetësorët, por më shumë mbështetet në të dhëna sekondare si statistikat e studentëve, stafit, kërkimit shkencor, programeve. Pavarësisht sa më sipër, nga DVV si dhe nga vizita në institucion, GVJ nuk konstatoi praktika të shpërndarjes së vlerësimit të pyetësorëve tek stafi. GVJ sugjeron që institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyërë konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjitshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se KUQ, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit dhe rregullores së KUQ si dhe rregullores së NJSBC.<br><br>*Referenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në | Referuar përbërjes së Njësisë të Sigurimit të Cilësisë, ai rezulton të ketë në përbërje përfaqsues 5 anëtarë, 4 janë staf |

| | |
|---|---|
| funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | akademik pa funksione drejtuese dhe 1 përfaqsues i studentëve, duke iu referuar rregullores së NJSBC neni 9. Kjo strukture funksionon mbi bazë te rregullores se NJSBC me mandat 3 vjecar. *GVJ sugjeron përfshirjen në NJSBC në pozicion konsultativ, të një eksperti të jashtëm të sigurimit të cilësisë.*<br><br>*Referenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021.pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | KUQ rezulton të ketë përfunduar akreditimin institucional si dhe i nështrohet akreditimit programor, sic është edhe ky proces vlerësimi periodic. Përveç akreditimit institucional si sigurimi i jashtëm i cilësisë, institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC.<br><br>*Referenca: Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Referenca: Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf*<br><br>*Referenca: An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | Nga dosja e vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se përdoren disa mekanizma, si monitorim i vazhdueshëm nga njësia bazë/kryesore, sondazhi i studentëve me një përiodicitet dy herë/vit për vleresimin akademik, pyetësori për vlerësimin e infrastrukturës si dhe pyetësori i kënaqësisë së stafit si dhe monitorimi i procesve të mësimdhënies.<br><br>Siç u konstatua gjatë vizitës në institucion, *GVJ sugjeron qe rezultatet e pyetësorëve të shpërndahen edhe individualisht stafit akademik, të diskutohen rezultatet dhe të orientohen me rekomandime për përmirësim si në diskutime në njësinë bazë si dhe të jenë pjesë e raportit që NJSBC bën.*<br><br>*Referenca: Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf*<br><br>*Referenca: Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Kolegji Universitar Kuq, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.*<br><br>*GVJ sugjeron qe rezultatet e pyetësorëve të shpërndahen edhe individualisht stafit akademik, të diskutohen rezultatet dhe të orientohen me rekomandime për përmirësim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse | Ne DVV, GVJ konsultoi planin e punës së NJSBC dhe identifikoi disa mekanizma formal nga manuali i cilësisë dhe nga rregullorja e NJSBC- sondazhe çdo fund semestri, për të vlerësuar aspekte të cilësisë së programeve të studimit, relacion mbi sezonet e provimeve, kontroll i evidencave dhe regjistrave, anketimet periodike të studentëve.<br><br>Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezulton se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen dhe hartohet në vijim një raport përmbledhës qe përmban rekomandime sipas gjetjeve. Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVJ, gjatë këtij procesi. GVJ konstaton se raporti është një raport shumë sintetik, nuk identifikon në mënyrë specifike analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Ky raport nuk identifikon gjetje kryesore nga mekanizma të tillë sic janë pyetësorët, por më shumë mbështet në të dhëna sekondare si statistikat e studentëve, stafit, kërkimit shkencor, programeve. |

| | |
|---|---|
| dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Pavarësisht sa më sipër, nga DVV si dhe nga vizita në institucion, GVJ nuk konstatoi praktika të shpërndarjes së vlerësimit të pyetësorëve tek stafi. *GVJ sugjeron që institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyërë konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjitshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara.*<br><br>*Referenca: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf*<br>*Referenca: An._3_37_ Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë(NJSBC) viti akademik 2021-2022..pdf*<br>*Referenca: An._3_20_ Pyetësorët e studentëve..pdf*<br>*Referenca: An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf*<br>*Referenca: An._3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen.pdf* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga përsoneli akademik dhe studentët. | Referuar RVB, rezulton se raporti i vlerësimit të brendshëm, përmban pikat e forta dhe të dobta të PS Bachelor në Menaxhim Biznesi. Gjithashtu referuar raportit vjetor të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ai përmban analizën e gjetjeve kryesore dhe rekomandime të lëna për adresimin e problematikave, për strukturat specifike akademike dhe/ ose administrative të KUQ.<br><br>*Referenca: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf* |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, | GVJ konstatoi se në Bachelor në Menaxhim Biznesi, përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, Kurrikulës, të mësuarit, të cilat shihen se janë të përfshira në seksionet e pyetësorit në sondazhet e studentëve.<br>*GVJ sugjeron që rezultatet e tyre duhen t'ju shpërndahen në mënyrë anonime stafit akademik dhe të analizohen gjetjet* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
E-mail: info@ascal.al
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | *kryesore në nivel programor dhe të ndërtohen rekomandimet për përmirësim të vazhdueshëm.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të përsonelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Sic GVJ është shprehur edhe për vlerësimin e kritereve më sipër, KUQ për vlerësimin e cilësisë, sanksionon përdorimin sondazhin e studentëve, të studentëve para diplomimit dhe të pyetësorit të gjurmimit, monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e përformances së stafit akademik.<br><br>*GVJ sugjeron* krijimin e një Bordi Pune, i cili do të krijonte mundësi për të tërhequr opinionin e bizneseve lokale dhe Alumnit dhe sugjerimet për përshtatjen me kërkesat në zhvillim të tregut të punës për aftësi dhe zotësi që studentët e diplomuar duhet të kenë, në përfundim të Bachelor në Menaxhim Biznesi për të qenë më konkurrues në tregun rajonal dhe më gjerë. |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se KUQ monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike. GVJ sugjeron që rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe të atyre para diplomimit, duhen t'ju shpërndahen në mënyrë anonime stafit akademik dhe të analizohen gjetjet kryesore në nivel* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *programor dhe të ndërtohen rekomandimet për përmirësim të vazhdueshëm.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, përsonelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Konstatohet se në përbërje të njësise të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se janë 5 anëtarë, 4 staf akademik dhe studentët përfaqësohen nga një anëtar, duke garantuar përfaqësim të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. NJSBC ka tësanksionuar funksionimin e saj në rregulloren e NJSBC dhe në Manualin e cilësisë. *GVJ është e mendimit se institucioni mund të përfshijë edhe ekspertë të jashtëm të sigurimit të cilësisë për të sjellë një qasje objektive apo kritike si stakeholdërs i jashtëm.*<br><br>*An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf*<br>*An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf*<br>*An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Të gjitha strukturat e përfshira në sigurimin e cilësisë, si NJSBC, njësia kryesore, njësia bazë etj, i kanë të sanksionuara të drejtat dhe detyrimet e tyre në Rregulloren e institucionit. NjSBC gjithashtu operon mbështetur në rregulloren e organizimit të NJSBC. Në këto akte rregullative rezultojnë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe procedurat që ndiqen.<br><br>*Referenca: An._3_42_ Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë.pdf*<br>*Referenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf*<br>*Referenca: An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf* |

| | |
|---|---|
| | *Referenca: An._3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesit..pdf* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të përsonelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Konstatohet se anëtarë te njësisë kryesore janë pjesë e NJSBC përveç faktit që siç rezultoi nga vizita në institucion, anëtarët e departamentit janë pjesë edhe e grupeve të vlerësimit të brendshëm programor. Gjithashtu studentët kanë përfaqsuesin e vetë, në NJSBC si dhe në GVB. Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e cështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e PS Bachelor në Menaxhim Biznesi, si për stafin akademik, studentët dhe institucionin në tërësi. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt përsonelit dhe studentëve. | GVJ konstatoi se pyetësorët zhvillohen anonim, që studentët të trajtojnë me sa më shumë objektivitet informacionin konfidencial, sipas NJSBC përpunimi i tyre dhe analizimi bëhet në terma të përgjithshëm, dhe synon të shmangë diskriminimin apo pabarazinë kundrejt personelit të vlerësuar dhe studentëve që kanë vlerësuar.<br><br>*GVJ sugjeron që IAL të përfshijë stakeholders te jashtëm si, bizneset dhe Alumnin në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se KUQ përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë dhe NJSBC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka edhe përfaqësues të studentëve. GVJ sugjeron që IAL të përfshijë stakeholders te jashtëm si, bizneset dhe Alumnin në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ referuar DVV dhe ëebit zyrtar të KUQ, konstaton se rregullore e NJSBC, përbërja e NJSBC si dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.<br><br>*Referenca: Kolegji Universitar Qiriazi* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat përsonale. | Rregullore e NJSBC, Plani i punës së NJSBC rezultojnë të publikuar në faqen zyrtare. Raporti i hartuar nga NJSBC respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat përsonale, ai paraqitet ne termat të përgjithshem, duke respektuar integritetin e stafit.<br><br>*Referenca: An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf*<br>*Referenca: An._1_5_1_Manuali i Cilësisë së KUQ.pdf* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Ky raport rezulton të ketë të përcaktuara edhe masat për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucioni, edhe pse *GVJ është e mendimit se raporti duhet të jetë më i detajuar dhe rekomandimet më specifike në nivel njësie kryesore a bazë apo edhe programor.*<br><br>GVJ konsultoi raportin vjetor te institucionit, qe një nga çështjet që trajton ka Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe raportin e NJSBC. Raporti i NJSBC, shoqërohet me përfundime si dhe rekomandime.<br><br>*Referenca: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Sipas RVB, zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raporton në mënyrë të vazhdueshme, për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën adresohen edhe rekomandime. Ky raport i drejtohet rektorit e me pas në varësi të problematikave shpërndahet ne njësitë kryesore.<br><br>*Referenca: An._3_12_1_Raporti mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore në FE..pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me përsonelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga takimi me strukturat drejtuese rezulton se KUQ, nëpërmjet strukturave drejtuese, njësive kryesore apo/edhe njësisë bazë, organizon veprimtari me stafin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes në trajnime, për akreditimin institucional dhe atij programor.<br><br>*Pavarësisht sa më sipër <u>GVJ sugjeron</u> që stafi dhe studentet duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre në këtë proces, kryesisht për pyetësorët e realizuar dhe rezultatet e tyre, gjithmone duke ruajtuar integritetin e palëve të përfshira.* |
| **Konkluzione** | *GVJ është e mendimit se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit PS në Bachelor në Menaxhim Biznesi, janë publike dhe transparente dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së PS në Bachelor në Menaxhim Biznesi. Pavarësisht sa më sipër <u>GVJ sugjeron</u> që stafi dhe studentet duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre në këtë process, kryesisht për pyetësorët e realizuar dhe rezultatet e tyre, gjithmone duke ruajtuar integritetin e palëve të përfshira.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

**Adresa: "Rruga e Durrësit"**

**E-mail: info@ascal.al**

**Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë**
**Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al**

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim Biznesi" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "Qiriazi"**

1- Mësimdhënia realizohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën akademike.
2- Infrastruktura fizike permbush kushtet në funksion të realizimit efektiv të procesit mësimor.
3- Ndërthurja e njohurive teorike me praktikën. Marreveshjet e nënshkruara me Institucione dhe biznese të ndryshme, i lehtësojnë studentët si në procesin e të mësuarit dhe në praktikën profesionale.

**Pika të dobta:**

1. Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" fokusohet dhe profilizohet më tepër në fushën e financës. [(Standardi II.1)]
2. Studimi i tregut nuk nxjerr në pah nevojat aktuale të tregut të punës [(Standardi II.4, Kriteri 6&7)]
3. Vihet re mungesa e takimeve tw IAL-sw me bordin e tregut tw punws, Alumni (Standardi II.4, Kriteri 6 &7)
4. Syllabuset lëndore nuk janë përditësuar me literaturë bashkëkohore. [(Standardi II.3, Kriteri 5)]
5. Biblioteka me numër të kufizuar titujsh, mungesë e rregjistrimeve në librari elektronike dhe kapacitete fizike te bibliotekës dhe të tekonologjisë së informacionit të vogla. [*(Standardi IV.3, Kriteri 2, 3, 4, 6)]*
6. Programi i studimit bachelor në MB, ka një numër të vogël studentësh dhe të ardhurat që vijnë prej tarifave të studentëve të programit janë të vogla. Gjithashtu të ardhurat nga burime të tjera të diversifikuara, si shërbime ndaj të tretëve apo të ardhura nga projektet mungojnë. [*(Standardi IV.5, Kriteri 2, 5)]*
7. GVj konstaton se raporti i NJSBC, nuk perfshin analizimin e pyetësorëve, në nivel njësie kryesore, departamenti apo programi. Ky raport nuk identifikon gjetje kryesore nga pyetësorët, por më shumë mbështet në të dhëna sekondare si statistikat e studentëve, stafit, kërkimit shkencor, programeve. [*(Standardi VI.3, Kriteri 1; Standardi VI.5, Kriteri 5).*]
   Stafi akademik dhe studentë kanë nevoje për më shumë informim dhe sensibilizim rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të Cilësisë [*(Standardi VI.5 /Kriteri 5)]*

**Rekomandime:**

1. GVJ sugjeron se programi duhet të garantojë llojshmëri profesionesh dhe specialitetesh, duke mos u fokusuar dhe profilizuar në fushën e financës. [(Standardi II.1)]
2. GVJ sugjeron një analizë më të detajuar të tregut të punës që nxjerr në pah nevojat aktuale të tij apo aftësitë që kërkohen më tepër. [(Standardi II.4, Kriteri 6&7)]

3. GVJ sugjeron se IAL duhet të realizojë takime me bordin e tregut të punës, Alumni për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. [(Standardi II.4, Kriteri 6&7)]
4. GVJ sugjeron përfshirjen e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë. [(Standardi II.3, Kriteri 5)]
5. *GVJ sugjeron* pasurimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet e viteve të fundit të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në Menaxhim Biznesi si dhe aksesimin ne biblioteka elektronike si dhe rritjen e kapciteteve infrastrukturale te bibliotekës me poste fizike dhe infrastrukture digjitale, PC dhe softe te përshtatshme. *[(Standardi IV.3, Kriteri 2.3.4.6)]*
6. *GVJ sugjeron që*, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve KUQ duhet të sigurojë forma alternativa të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj. *[(Standardi IV.5, Kriteri 2, 5)]*
7. *GVJ sugjeron* që lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë: *[(Standardi VI.3, Kriteri 1; Standardi VI.5, Kriteri 5, (Standardi VI.5 /Kriteri 5)]*
   - institucioni të shpërndajë rezultatet e pyetesorëve për vlerësimet individuale në mënyrë konfidenciale dhe të trajtojë në terma të përgjithshëm problematikat e dala dhe praktikat e mira të identifikuara.
   - Raporti i NJSBC duhet të jetë më analitik si dhe të përfshijë gjetjet e pyetësorëve dhe rekomandime prej këtyre gjetjeve, ne nivel programi studimi.
   - stafi dhe studentët duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre dhe strukturave të tjera në këtë proces.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Management of Business" offered by the Institution of Higher Education "Qiriazi University College"**

**Strengths and affirmations**

1. Teaching is carried out by a qualified academic staff with experience in the academic field.
2. The physical infrastructure meets the conditions for the effective implementation of the teaching process.
3. Integration of theoretical knowledge with practice. Agreements signed with various institutions and businesses facilitate students both in the learning process and in professional practice.

**Weaknesses**

1. The Bachelor's program in "Business Management" has a specific focus and specialization in finance. [*(Standard II.1)]*
2. The market study fails to emphasize the present requirements of the labour market. [*(Standard II.4, Criteria 6 & 7)]*

3. It is observed that there have been no HEI meetings with the Alumni labor market board. [(*Standard II.4, Criteria 6 &7)]*
4. Current literature has not been incorporated into subject syllabus [(*Standard II.3, Criteria 5)]*
5. Library with a limited number of titles, lack of registrations in the electronic library, and small physical capacities of the library and information technology. [*(Standard IV.3, Criteria 2, 3, 4, 6)]*
6. The bachelor study program in MB has a small number of students, and the revenues from student fees are low. Also, revenues from other diversified sources, such as third-party services or project revenues, are lacking. [*(Standard IV.5, Criteria 2, 5)]*
7. The EEG notes that the NJSBC report does not include the analysis of questionnaires at the level of major units, departments, or programs. This report does not identify key findings from the questionnaires, but relies more on secondary data such as student statistics, staff, research, and programs. [*(Standard VI.3, Criterion 1; Standard VI.5, Criterion 5).]* Academic staff and students need more information and awareness about internal quality assurance processes. [*(Standard VI.5, Criterion 5)]*

**Recommendation**

1. EEG suggests that the program should ensure a diverse range of professions and expertise, rather than solely emphasizing and specializing in the finance industry. [(Standard II.1)]
2. EEG suggests doing a comprehensive examination of the labor market, specifically focusing on its present requirements and the talents that are in higher demand. [(Standard II.4, Criteria 6&7)]
3. EEG suggests that HEI should convene meetings with the labor market board and Alumni in order to leverage their expertise as a crucial source of knowledge that facilitates the adjustment to the labor market's requirements. [(Standard II.4, Criteria 6&7)]
4. EEG suggests incorporating contemporary literature in both the names and year of publication to provide students with the most up-to-date information in their field of study. [(Standard II.3, Criteria 5)]
5. *EEG suggests* enriching and updating the physical library collection with recent publications of titles in line with the Business Management bachelor's program, as well as accessing electronic libraries and increasing the infrastructure capacities of the library with physical posts and digital infrastructure, PCs, and appropriate software. [(Standard IV.3, Criteria 2, 3, 4, 6)].
6. *EEG suggests* that, given the reduction in the number of students, institution should ensure alternative forms of fundraising in the future from national and international projects, etc. [(Standard IV.5, Criteria 2, 5)]
7. *EEG suggests* regarding internal quality assurance: [(Standard VI.3, Criterion 1; Standard VI.5, Criterion 5)]
    - The institution should distribute questionnaire results for individual assessments confidentially and address emerging issues and identified best practices in general terms.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423 Web site: www.ascal.al

- The report of the Unit of Internal Quality Assurance should be more analytical and include questionnaire findings and recommendations from these findings at the program study level.
- Staff and students should be more sensitized, informed, and aware of internal quality assurance processes and their roles and other structures in this process.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE** | | | | **X** |
| **VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR** | | | **X** | |
| **VLERËSIMI TËRËSOR** | | | **X** | |